Ana konstruktive e kuadrit elektrik te TU është plotësimi dhe ndërtimi i tyre i brëndshëm me kite dhe aksesoret e vetë. Asemblimi i paneleve në mënyrën e duhur dhe arkitekturën e përshtatshme lejon një hapsirë të mjaftueshme për plotësimin e kushteve të punës së automatëve dhe eliminon gabimet njerëzore në montim dhe vendosjen e tyre. E këshillueshme është përdorimi i strukturave modulare.




Figura 3 : Kite të gatshme dhe aksesorë të nevojshëm




Figura 4 : Struktura të realizuara me kite dhe aksesorët e duhur të konsumatorit

3.5 Automatet mbrojtës

Pajisjet mbrojtëse duhet të jenë automatë sipas normës CEI 60898 dhe CEI 60947-2 si në figurën 5 dhe figurën 6. Këta automatë mbrojnë pajisjet dhe sigurojnë një veprim të shpejtë nga mbingarkesa dhe lidhjet e shkurta. Këta automatë duhet të lidhen para pajisjeve fundore dhe qarqeve të cilat nuk kanë prezencë direkte të personelit.



Figura 5 : Automatë një dhe dy polarë sipas CEI 60898

Karakteristikat e automatëve:

- Rryma e lidhjes shkurtër: 6 kA;
- Rryma nominale: 6 – 32A;
- Tensioni nominal i punës: 230V;
- Numri i cikleve: 20 000.



Figura 6 : Automatë dy polarë sipas CEI 60947-2

Karakteristikat e automatëve:

- Rryma e lidhjes shkurtër: 6-10 kA
- Rryma nominale: 10–63A
- Tensioni nominal i punës: 230V
- Karakteristika e rënies: “C”
- Numri i cikleve: 10 000 - 20 000

Automatët diferencialë dhe MT diferencialë sipas normës CEI 61008, sigurojnë përveç mbrojtjes nga mbingarkesa dhe lidhjet e shkurtra edhe mbrojtjen nga rrymat e rrjedhjes me tokën. Në këtë mënyrë sigurojnë personelin nga ndonjë gabim i mundshëm gjatë instalimit dhe gjatë dëmtimit të pajisjeve të cilat kanë kontakt

direkt me të. Në mënyrë kategorike të gjitha qarqet e mësipërme duhet të mbrohen me automatë diferencialë sipas Figures 7.



Figura 7 : Automatë diferencialë dy polare dhe katër polare sipas CEI 6100

Karakteristikat e automatëve diferenciale:

- Rryma nominale: 25 - 100A;
- Tensioni nominal i punës: 230/400V;
- Karakteristika e rënies: “C”;
- Numri i cikleve: 2500;

Automatët e fuqisë sipas normës CEI 60947-2 të përshtatshëm për panelet TU si ata kryesore ashtu edhe ata shpërndarës të kateve. Sigurojnë dhe garantojnë furnizimin me energji të të gjithë objektit dhe mbrojnë gjithë panelin dhe instalimin nga lidhjet e shkurtra dhe nga mbingarkesat. Këta automatë janë me mbrojtje termike nga mbingarkesat të rregulleshme. Në të gjitha rastet kur ngarkesat e llogaritura e kalojnë rrymën 80A duhet të përdoren automatë si në figurën 10.



Figura 8 : Automatë magnetotermikë tre dhe katër polarë sipas CEI 60947-2

Karakteristikat e automatëve magnetotermikë:

- Rryma nominale: 80 - 250A;
- Tensioni nominal i punës: 380/415V;
- Karakteristika e rënies: “C”;
- Tarimi i rymës termike: $(0.7 - 1) \times I_n$;
- Numri i cikleve mekanikë: 40 000;
- Numri i cikleve elektrike: 20 000

Pajisjet mbrojtëse nga mbitensionet sipas normës CEI 61643, shërbejnë për të mbrojtur sistemin elektrik nga mbitensione të paparashikuara të ndodhura nga goditjet e rrufeve apo edhe të atyre goditjeve që vijnë nga vetë rrjeti shpërndarës OSHEE gjatë komutimeve të ndryshme dhe gjatë defekteve të rënda në pajisjet transformuese.



Figura 9 : Shkarkues nga mbitensioni një dhe tre fazore sipas CEI 61643

Karakteristikat e shkarkuesve nga mbitensioni:

- Tensioni nominal i punës: 230/400V;
- Frekuenca: 50Hz;
- Fuqia e shkycjes: 25kA;
- Koha e veprimit: 25ns;
- Temperatura punës: -25, +60C;

Pajisjet matëse sipas normës CEI 60051 shërbejnë për një kontroll të thjeshtë të parametrevë të sistemit elektrik. Të domosdoshme gjatë mirëmbajtjes si dhe për eliminim sa më të shpejt të defekteve, këto pajisje ndihmojnë personelin teknik të shërbimit të veprorë shpejt në rast defekti të mundshëm dhe të vrojtojnë në mënyrë periodike të dhënat bazë të rrjetit elektrik si rryma dhe tensioni.

Për personelin e kualifikuar, për kontrollin dhe matjen e saktë të konsumit të energjisë dhe për vrojtimin e parametrevë specifike si koeficienti i fuqisë të përdoren pajisje sipas normës IEC 62053-21 si në figurën 12. Këto pajisje sigurojnë një cilësi të matjes së energjisë aktive në shkallën 1 dhe të energjisë reaktive në shkallë 2.



Figura 10 : Pajisje matëse digjitale sipas IEC 62053-21

Karakteristikat e pajisjeve matëse digjitale:

- Tensioni nominal i punës: 230/400V;
- Frekuenca: 50Hz
- Klasa saktësisë për rymën: 0.5%;
- Klasa saktësisë për tensionin: 2%;
- Klasa saktësisë për energjinë: 2%;
- Komunkimi MODBUS, RS485

3.6 Prizat e Fuqisë

Te gjitha prizat, jane te tipit 16A. Ato duhet te kene montim rafsh dhe duhet te kene nje ngjyre qe te shkoje me kapaket e çelesave te ndriçimit. Ky sistem është vendosur ne te gjitha ambientet e godines. Prizat jane 230V, 16A, me tokëzim .

Instalimet elektrike te fuqise dhe sinjalizimit qe kalojne ne dysheme behen me tub te rende, kurse ato qe kalojne ne mure dhe tavane jane te serise se lehte. Tubat e dyshemese jane vendosur nen shtresat e dyshemese dhe ne mure brenda suvase dhe behen para se muret te suvatohen. Tubat duhet te jene te gjithe te pa djegeshme. Projekti parashikon mbrojtjen diferenciale me rele diferenciale 0.03A $R_t < 4$ dhe mbrojtjen nga LSH me automat termoelektromagnetik.01.

Linjat e furnizimit jane me tre percjelles (kafe = faze, blu = nul, e verdhe = tokëzim).

Karakteristikat e automateve duhet te zbatohen rigorozisht sipas klasit A. B. C. D. karakteristika termike e momentit te inercise) per te garantuar selektivitet. Percjellesit qe do te perdoren do te jene fleksibel antifiami. Instalimi i elementeve do te behet si me poshte:

- Lartesia e kuadrit do te jete 170cm nga dyshemeja.
- Lartesia e çelsave do te jete 110 cm nga dyshemeja.
- Lartesia e kutive shperndarese 30 cm nga dyshemeja.
- Lartesia e prizave do te jete 45 cm nga dyshemeja.

Persa i perket sistemit te prizave te fuqise ato jane vendosur ne vizatime mbeshtetur ne planimetrit dhe arredimin e brendshem te ambienteve. Te gjitha prizat jane te tipit shuko dhe te pajisura me tokezim. Prizat e tensionit njefazore siç tregohen edhe ne figuren e meposhtme jane montuar ne te gjithe ambientet godines. Te gjitha prizat jane 16A.



Figura 11 : Prize shuko universale

3.7 Kanalet dhe aksesoret

Instalime elektrike do te te behen ne dy menyra

- Nen suva te futura ne tuba PVC fleksibel
- Mbi suva ne kanalina metalike te montuara ne koridore.

Aksesoret e instalimeve nen suva jane:

- Tubat fleksibel PVC te dimensioneve te ndryshme ne varesi te dimensionit dhe te numrit te telave/kabllove qe do te futen ne te.
- Kutite per fiksimin e prizave ose te çelesave. Te gjitha keto vendosen para se te behet suvatimi.

Per kryerjen e instalimeve elektrike te futura nen suva duhet te ndiqet rradha e punes si me poshte:

- Hapja e kanaleve ne mur me dimension te tille qe te vendoset lirshem tubi fleksibel dhe me thellesi te tille qe te mos dale mbi nivelin e suvase perfundimtare.
- Vendosen tubat fleksibel dhe kutite prej PVC te cilet provizorisht fiksohen me allçi (me vone mbyllen kanalet me llaç suvatimi)
- Pasi eshte kryer suvatimi, futen telat ose kabllot, me ane te udhezuesit te tyre, te cilat duhet te hyjne lirshem dhe te lihet ne te dy krahet nje sasi e mjaftueshme per kryerjen e lidhjeve dhe montimeve.
- Kanalet dhe vendosja e tubave fleksibel PVC duhet te behet ne distance 0.4 m me poshte nga niveli i tavanit ne vije te drejte horizontale dhe zbritjet per çelasa ose prizat te behen vertikale te drejta dhe jo me kend ose ne forme harku.
- Kutite shperndarese ne varesi te sistemit qe do te perdoret jane per nen suvatim ose mbi suvatim keshtu qe menyra e fiksimit te tyre eshte ose me allçi ose me ane te vidave me upa.
- Permasat e kutive shperndarese variojne sipas rastit dhe nevojës. Ato jane ne forme rrethore, katrore ose drejtkendeshe dhe kapaket e tyre mbylles fiksohen me vida.

E rëndësishme eshte qe lidhja e telave/kabllove brenda ne kutite shperndarese te realizohet me ane te klemeve bashkuese/ kapucave lidhes, dhe jo me nastro. Sistemi i kanalave ashtu si sistemi nen suva me tuba fleksibel duhet te plotesoje te gjitha kushtet teknike te instalimeve elektrike.

4. Rrjeti i ndricimit normal

Per te gjithë ambientet eshte bere llogaritja e intesitetit te ndricimit. Mbeshtetur ne standardin europian EN 12464 eshte parashikuar vendosja si dhe numri i ndricueve per cdo ambient, me qellim arritjen e intesitetit te ndricimit te nevojshem.

Sipas EN 12464 duhet te respektohet me rigorozitet fuqia e ndricimit sipas ambjenteve si me poshte:

- Korridoret 200 lux
- Banjot 100 lux
- Doma e sherbimit 500 lux
- Dhoma e mirembajtjes 300lux

Me poshte jane paraqitur tipet e ndricueve te perdorur:

I gjithë rrjeti i ndricimit do te realizohet me percjellesa N07V-K, (pjesa nga kuadri elektrik deri ne kutine shperndarese). Vendodhja e çelesave te ndricimit tregohet sipas projektit dhe skicave te bera nga inxhinieri

elektrik projektues. Te gjithë celesat do te mentohen ne lartesine 110 cm nga dysHEMEJA. Ne pergjithesi celesat e ndriçimit gjate gjithë ndertesës duhet te jene te pershtatshme per montim te rrafshet (nen suvatim).

Çelesat sipas vendit ku do te perdoren dhe menyres se takim - stakimit i ndajme

- Çelesa ndricimi te thjeshte;
- Celesa deviat

Pavarësisht ambjentit i cili do të ndriçohet llogaritja e ndriçimit është bërë sipas normës EN 12464 duke krijuar një sipërfaqe uniforme të ndriçuar mirë në çdo pjesë të saj dhe të qetë për punën e personelit dhe të gjithë njerëzve.

Ndriçimi është projektuar sipas tipologjisë së ambjenteve duke plotësuar kushtet dhe normat mbi llojin e ndriçimit, niveleve të ndriçimit dhe rrezikshmërinë e instalimit të ndriçimit, që gjenerojnë dritë ultraviolet.

1. Tipi i ndriçuesit të përdorur në dhomen e mirembajtjes:

Në këte ambient janë përdorur ndriçues industrial LED me karakteristika si më poshtë:

- ▶ **Ndriçues LED, tipi i ndriçimit - direkt, 36W, IP-65, i montuar në sipërfaqe të tavanit. Jetëgjatësia në orë pune: 50 000 orë.**



Figure 12: Ndriçues LED 2x36W, i montuar ne dhomen e mirembajtjes

2. Tipet e ndriçuesve ne dhomen e sherbimit :





Figure 13: Ndiriçues LED 48w 60x60 6800lm 4500k, i montuar ne dhomen e sherbimit

3. Tipi i ndiriçuesve i vendosur në ambientet e tualetit:

► **Ndiriçues rrethor spot LED inkaso, 7W, IP-20.**




Figure 13: Ndiriçues LED 7W,

4. Tipi i ndiriçuesve i vendosur në tualet është:

► Ndriëues rrethor spot LED inkaso, 18W, IP-44



► *Figure 14: Ndriçues LED 18W, IP-44*

Ndriçimi do të jetë i ndryshëm në varësi të ambientit të shërbimeve , korridore,etj. Gjithashtu, ndriçuesit janë në varësi të arkitekturës dhe janë zgjedhje e arkitektit përkatës. I gjithë rrjeti i ndriçimit do të realizohet me kabëll FG7OR 3x1.5mm², (pjesa nga paneli elektrik deri në kutinë shpërndarëse të vendosur në çdo ambient). Të gjitha urat lidhëse ndërmjet ndriçuesve do të realizohen me kabëll FG7OR 3x1.5mm².

Vendodhja e çelësave të ndriçimit tregohet sipas projektit dhe skicave të bëra nga inxhinieri elektrik projektues. Në përgjithësi çelësat e ndriçimit gjatë gjithë ndërtesës duhet të jenë të përshtatshme për montim të rrafshët (nën suvatim). Të gjithë çelësat duhet të kenë një shkallë minimale prej 10-16A.

Çelësat sipas vendit ku do të përdoren dhe mënyrës së takim-stakimit i ndajmë:

- Çelës i thjeshtë një polar 230V, 16A;
- Çelës deviat 230V, 16A;
- Çelës pulsant 230V, 16A;

5. Sistemi i ndricimit te emergjences

Rrjeti i ndriçimit të emergjencave duhet të realizohet, sic jepet në projekt, ku përveç ndriçuesve të emergjencës të daljeve EXIT që ushqehen nga UPS, gjithashtu një pjesë e ndriçuesve të ambienteve ushqehen me UPS në mënyrë për të rritur sigurinë në raste paniku dhe të ndërprerjes së energjisë elektrike. Ndricimi i emergjences është projektuar plotësisht në përputhje me standardin evropian EN 1838.

Sistemi i emergjencës është realizuar duke vendosur në të gjitha korridoret, daljet jashtë dhe në rrugë kalimet në rast evakuimi, të ndriçuesve të emergjencës. Këto ndriçues janë me bateri, me autonomi 72ore. Në rast ndërprerje të energjisë elektrike, është parashikuar ndriçimi i avarisë që furnizohet me UPS, duke plotësuar kushte minimale të vizibilitetit në raste emergjence.



Figura 16: Ndricules emergjence dhe kiti i baterisë

Për këtë qëllim, krahas ndricuesve të ndriçimit që furnizohet nga rrjeti elektrik, është projektuar që një masë prej 10% e ndricuesve të ushqehen nga grupi i UPS, në këtë mënyrë eliminohet rreziku i panikut dhe ngjarjeve të jashtëzakonshme, në rastet e ndërprerjes së energjisë elektrike, duke siguruar ndriçimin në kushte minimale për evakuimin e personave duke pasur parasysh kategorinë e ndërtesës dhe rrezikshmerinë ndaj jetës së njerezve.

Ndriculesit e emergjencës dhe avarisë duhet të jenë me bateri Ni – Cd dhe mini – invertitorin, të tipit LED 1 x 8W. Vendosja e tyre do të bëhet në mënyrë të tillë që të sigurohet një shkallë ndriçimi prej 5lux, kurse pavarësia e funksionimit të tyre për ndërprerjen e rrjetit duhet të jetë të paktën 3 ore. Këta ndriçues do të qëndrojnë të aktivizuar (në punë) gjatë gjithë kohës. Në figurën e mësipërme tregohen ndricuesit e daljeve EXIT të vendosur në projekt mbështetur në standardin evropian EN 1838.

6. Sistemi i Data dhe Telefonisë

Sistemi i rrjetit të komunikimit të dhënave. Projekti parashikon montimin e sistemit të internetit. Ambientet që duhet të jenë të pajisura me prizat interneti RJ45, me qëllim realizimin e një sistemi komunikimi dhe transmetimit të të dhënave sa më mirë që të jetë e mundur.

Të gjithë sinjalet nga prizat e internetit do të mbledhen në një RACK i cili vendoset në ambientin teknik. Në RACK do të jetë i montuar, të gjithë elementet e sistemit të data, i cili do të bëjë të mundur marrjen e thirrjeve, si dhe shpërndarjen e tyre sipas nevojave. Prizat e IT do të instalohen në ambientet e shërbimit.

RACK-u kompjuterik përman:

- Rack kompjuterik 19" 11U, (dimensionet 22"H x 20.5"W x 20"D)
- Patch panel me 24 porta RJ-45 FTP CAT 6
- Switch interneti me 24 porta RJ-45 + 1 porte optike ftp cat 6 modul ushqimi me 3 prizat " shuko " 230v, 16A +PE
- Modul ups 500VA + modul ventilimi

Prizat kompjuterike furnizohen me kabell FTP CAT 6 direkt nga RACK, kalon në kanalit e kabllëve të rrymave të dobëta dhe në tubo PVC fleksibel të fortë d=20mm në pjesët e vendosura brenda në mur.

Ne një tub Ø20mm të mos përdoren me shume se dy kablllo interneti. Prizat e rrjetit data/(informatike) vendosen ne te njëjtën lartësi me prizat e tensionit dhe rekomandohen ne lartësi 0.3-0.4 m. Ato janë te tipit nen suvatim.



Figura 17 : Kabell FTP CAT 6 dhe modul prize kompjuterike dhe telefonie RJ-45

7. Sistemi i vëzhgimit CCTV

Sistemi i vëzhgimit me kamera si një element i rëndësishëm për sigurinë e objektit duhet të sigurojë jo vetëm cilësinë në shërbimin që ofron por edhe vazhdimësinë dhe sigurinë në punë. Kjo cilësi realizohet nëpërmjet “ Integrated Camera System ”.

Ky sistem perbehet nga:

- Network Video Regjistratori
- Monitori
- Kamerat e brendshme
- Kamerat e jashtme
- Kabllot lidhes FTP CAT6 dhe ato te furnizimit te kamerave me energji.

Sistemi i vëzhgimit CCTV :

- NVR 32 kanale 200Mbps Bit Rate Input Max (up to 32-ch IP video), 4 SATA Interfaces, alarm I/O: 16/4, 1.5U case, 19 Monitori.
- Switch i menaxhueshem me 28 Porta Gigabit POE.
- Kamera te brendshme– 3mpx, 30 metra IR Exir Dome Outdoor IR30 metra, 2048x1536: 12.5fps(P)/15fps(N), 2.8mm/F2.0 lens (4mm, 6mm optional).
- Kamera te jashtme 3 MPX resolution, Low illumination, lens:4mm 3D DNR & DWDR & BLC, System Compatibility: ONVIF, PSIA, CGI, ISAPI IP66 rating, Image Sensor:1/3" Progressive Scan CMOS IR range: up to 50m.
- Aksesore montimi per kamera te brendshme dhe te jashtme.

Në këtë sistem modern të kontrollit dhe vëzhgimit, në pjesët përbërëse të cilët përfshihen kamerat High Resolution, Wide Dinamic Range dhe Day and Night realizohen pamje të qarta dhe të qëndrueshme për 24 orë me radhë shtatë ditë në javë. Nëpërmjet teknologjise CCD, këto kamera arrijnë një shpejtësi fotografimi deri 30 imazhe për sekondë me një rezolucion deri 3 megapixel.

Ne ambjentet e brendshme te godines jane instaluar kamera me dalje IP kamerave të cilat nëpërmjet rrjetit LAN me kabell FTP CAT.6 apo edhe nepermjet internetit arrijnë kontrollin dhe monitorimin e tyre online. Kontrolli me kamera do të realizohet si kontroll në ambient të brendshem .Është zgjedhur një NVR 16 kanaleshe. Furnizimi i kamerave është bere me Kabell FTP CAT.6 (qe është dhe për sinjal dhe furnizim).

Kamerat ne ambjentet e brendshme dhe ato te jashtme jane vendosur sic jepen ne projektine sistemit te CCTV.



Figure 18: Kamera High-Resolution, Day/Night për ambjente të brendshme



Figure 19: Kamera me rezolucion te larte (dite/nate) për ambiente të jashtme

I gjithë informacioni video dhe imazh nëpërmjet NVR digitale, mund të përpunohet nga personeli i specializuar sipas kohës së ruajtjes dhe parametrave të përcaktuar më parë.



Figure 20: Serveri per ruajtjen dhe depozitimin e informacion dhe regjistrimeve

Network storage manager jep mundësinë e ruajtjes së informacionit për kohë të gjatë. I zgjerueshëm deri 24TB është praktikisht i pakufizuar në kohë dhe hapësirë. I gjithë informacioni i mbledhur për një kohë të caktuar grumbullohet dhe ruhet në storage duke siguruar përpunimin e tij dhe përmirësuar shërbimin sigurisë. I gjithë sistemi do të jete i licensuar me normat e Komunitetit Europian

8. Sistemi i tokëzimit dhe mbrojtjes nga shkarkimet atmosferike

Ne perputhje te plote me kerkesat e detyres se projektimit dhe mbeshtetur plotesisht mbi standartet IEC 62305. Eshte realizuar projekti i sistemit te tokezimit mbrojtjes dhe mbrojtjes se nderteses nga shkarkimet atmosferike. Sistemi i mbrojtjes atmosferike eshte shume i domosdoshem, per vete kushtet atmosferike dhe vendodhjen gjeografike ne te cilat ndodhet vendi yne.

Sipas standardit nderkombetar IEC 62305, percakton kater klase sistemesh mbrojtjeje (I, II, III, IV), qe iu korrespondojne nje sere rregullash ndertimi dhe lidhen me kater nivele mbrojtjesh (I, II, III, IV). Nga veshtrimi i pare nje efektshmeri mbrojtje globale respektive 98% (niveli I), 95% (niveli II), 90% (niveli III), 80% (niveli IV).

Cdo klase mbrojtjeje i caktohet nje grup vlerash minimale dhe maksimale te parametrave qe lidhen me amplitudat e rrymave te rrufeve per secilin prej niveleve te mbrojtjes. Vlerat maksimale te amplitudave te rrymave te rrufeve jane percaktuar respektivisht si 200 kA (99% e rrufeve) niveli I i mbrojtjes, 150 kA (97% e rrufeve) niveli II i mbrojtjes, 100 kA (91% e rrufeve) niveli III & IV i mbrojtjes.

Mbrojtja e nderteses nga shkarkimet atmosferike do të behet per te siguruar nga goditjet direkte dhe ato indirekte (efektet e dyta: induksionet elektromagnetike). Mbrojtja e nderteses nga shkarkimet atmosferike do të realizohet nepermjet nje rrjete ekuipotenciale ne planin e catise te objektit me percjelles te rumbullaket zingato $\varnothing=12\text{mm}$ dhe zbritjeve siç jane treguar ne projekt per ne elektrodas te tokezimit te vendosura nen planin e themeleve, me qellim shkarkimin e sigurte te mbitensioneve atmosferike te shkaktuara nga shkarkime te mundsheme atmosferike. Mbrojtja nga efektet e dyta të linjave elektrike dhe atyre të telefonisë do të behet, përveç masave të tjera që përshkruhen në normat VDE, edhe me anën e shkarkuesve të përshtatshëm.

Instalimi i sistemit te tokezimit dhe mbrojtjes nga shkarkimet atmosferike behet si meposhte:

- Rrjeta tokezuese nen themele ndertohet me shirit zingato 30x5mm. Bashkimet e shiritave te tokezimit behen me morseteri zingato (detaje te prodhimit industrial).
- Cdo 2m shtrirje horizontale te shiritit te tokezimit me armaturen e pllakes ne themele, dhe çdo 2m ngjitje ne kollona, shiriti i tokezimit te bashkohet me hekurat e armatures me morseteri zingato. Morseterite jane prodhim industrial te prodhuara per kete qellim.
- Ndermjet perimetrit te themeleve dhe skarpates se dheut, vendosen elektroda tokezimi tip profil zingato me gjatesi $L=2.0\text{m}$. Elektrodas lidhen me rrjeten tokezuese.
- Nga morseteria per shkeputjen e tokezimit deri ne tarrace, shiriti i tokezimit qe ngjitet ne kollona vazhdon deri tek terminali i rrufepritesit, me shirit zingato 30x5mm.
- Rrjeta rrufepritesese mbi tarrace ndertohet me shirit zingato 20x5mm. ky shirit i rrjetes se rrufepritesit fiksohet ne kubike betoni me veshje pvc cdo 1m shtrirje.
- Ne varesi te lartesis se paisjes se kondicionimit do te percaktohet edhe konstruksioni mbajtes i shtizes. Te gjitha konstruksionet metalike te paisjeve do te lidhen me sistemin e mbrojtjes nga shkarkimet atmosferike.
- Sa i përket godinës , në projekt është parashikuar vendosja e rrjetës së tokëzimit , per te rritur sigurine e mbrojtjes se nderteses nga shkarkimet atmosferike.

- Rezistenca e tokëzimit duhet të jete me e vogel se 2 ohm, ne te kundert duhet te qe shtohen elektrodut e tokëzimit derisa ky kusht te plotesohet.



Figure 15: Detaje konstruktive të sistemit të tokëzimit dhe rrufepritësave

Te gjitha paisjet metalike, komponentet më të gjatë se një 1m, do të lidhen me sistemin e mbrojtjes ndaj rrufeve. Të gjitha komponentet më të larta se sipërfaqja e tarracës janë ruajtur në mënyrë direkte nga shtizat e pritjes së goditjeve atmosferike.

Të gjitha paisjet metalike, panelet elektrike, kanalinat dhe çdo pjesë tjetër e sistemit e cila normalisht nuk është në tension , por që rastësisht mund të bjerë në tension nga shkaqe të ndryshme , duhet të tokëzohet (dhe lidhet) me këtë pllakë ekuipotenciale.

Projektuesi

“TAULANT” sh.p.k

Drejtuese Ligjore

Znj. Ditika Qatipi

RAPORT TEKNIK PER SISTEMIN E KAMERAVE

EMERTIMI I PROJEKTIT:

INVESTIME PËR TRANSFORMIMIN E ASETVE PUBLIKE ME
POTENCIAL ZHVILLIMI NË MODELE TË STANDARDIT MË TË LARTË TË ZHVILLIMIT:
PËRMIRËSIMI I SHËRBIMIT NË KOPSHTIN NR.4,
RRUGA “ADEM SHEME”, SARANDË

Hartuesi i projektit : B.O.E “Taulant” sh.p.k,

“Arkimade” sh.p.k &

“Altea Geostudio” sh.p.k

Porositësi: Fondi Shqiptar I Zhvillimit



**FONDI SHQIPTAR
I ZHVILLIMIT**

a. Kerkesa te Projektit

Objektivi kryesor i përzgjedhjes së këtij shërbimi është krijimi i një sistemi të integruar sigurie. Nëpërmjet këtij shërbimi bëhet i mundur realizimi i:

- Monitorimi 24/7 gjatë gjithë vitit për parandalimin në kohë reale të incidenteve të ndryshme. Ruajtja e të dhënave/ provave në databazën e serverit kur konstatohen shkelje sipas përcaktimeve ligjore të Ligjit Nr. 19/2016 “Për masat shtesë të sigurisë publike”.
- Nëpërmjet implementimit të një sistemi të sofistikuar sigurie, përfitohet përmirësim të niveleve të sigurisë për të identifikuar e parandaluar rreziqet, ofrimin e një shërbimi të vazhdueshëm, përforcim të standarteve të shërbimit, rritjen e efikasitetit operacional dhe reduktimin të kostove.

Sistem sigurie:

Përveçse një aset në objekte, implementimi i këtij sistemi është një detyrim i vazhdueshëm që vjen si pasojë e kërkesës nga institucionet përkatëse dhe organet kompetente për rendin dhe sigurinë publike në vend në funksion të mësimdhënies dhe mundëson qëllimin final, që janë ambientet të sigurta e të mbrojtura.

b. Zgjidhja teknike

Grupi i projektimit te studios se projektimit "Taulant" shpk per hartimin e projektit u bazua ne detyren e projektimit te hartuar nga autoriteti kontraktues.

Gjatë periudhës së hartimit të projekt-preventivit të zbatimit kemi informuar dhe jemi konsultuar paraprakisht me stafin e AK, në mënyrë që çdo sugjerim për ndryshim, përmirësim apo paqartësi mes palëve të bëhej gjatë intervalit kohor të bërjes së projektit.

Nëpërmjet këtij projekti do të realizohet:

- Krijimin e sistemit të integruar (kamera sigurie);
- Detektimin dhe zbulimin në kohë reale të aktiviteteve të paligjshme e, zjarreve, si dhe ndërhyrjen e menjëhershme të grupeve të gatshme;
- Monitorimi 24 orë në 365 ditë të vitit për parandalimin në kohë reale të aktiviteteve të paligjshme;
- Shkëmbim informacioni në kohë reale me strukturat e tjera përgjegjëse për monitorimin dhe ndjekjen e autorëve të veprimeve të kundra ligjshme;
- Ruajtja e të dhënave/ provave në databazën e serverit kur konstatohen shkelje dhe referimi i tyre në institucionet përkatëse (polici, gjykata, prokurori etj).

c. Siguria e sistemit të integruar:

-Ruajtje e sigurtë e të dhënave. Të dhënat në sistemet do të jenë 100% të sigurta dhe do të jetë e pamundur të fshihet ndonjë e dhënë.

-Sistemi i integruar i shërbimeve është një hap i rëndësishëm në monitorimin dhe rritjen e parametrave të sigurisë dhe padyshim një kontribut i mirë që i jepet përmirësimit të rendit në tërësi.

Nëpërmjet implementimit të shërbimeve të integruara synojmë të rrisim sigurinë, si dhe të reduktojmë rrezikun nga aktivitete të paligjshme, dëmtimet apo rastet e emergjencës në institucione.

Ky sistem do të funksionojë në kohë rekord dhe do të mundësojë:

Akses total në sistem, koordinim me institucionet përkatëse, si dhe bashkëpunim më i ngushtë midis institucioneve dhe shërbimeve të sigurisë.

-Parandalim i krimeve: Kontrolli 24/7 mundëson vëzhgimin deri në asimilimin e rasteve të rrezikshme;

-Reagim i menjëhershëm: evidentim dhe ndërhyrje e menjëhershme pasi nëpërmjet sistemit çdo department reagon;

-Eficiençë në menaxhim: Organizim i saktë i gjithë procedurave standarte nga lajmërimi deri tek zgjidhja e situates në vendngjarje;


-Zgjidhje ekonomike: reduktim i kostove, ofrim shërbimi në terma afatgjatë nëpërmjet një sistemi të unifikuar shërbimesh sigurie, duke përfshirë projektim-implementim-mirëmbajtje;

-Rritja e përgjegjshmërisë: ky sistem jo vetëm siguron por edhe kontrollon, duke rritur përgjegjshmërinë ndaj detyrave;

Parandalim i dëmeve fizike: kombinimi perfekt i teknologjisë me forcën njerëzore minimizon humbjet dhe dëmtimet në objekte, nëpërmjet kamerave, sensorëve dhe sinjalizuesve.

-Institucionet e ruajtjes së rendit dhe sigurisë publike kanë një referencë më shumë për të monitoruar dhe kjo është një masë që do të sjell jo vetëm përmirësimin e sigurisë, por edhe shmangien dhe parandalimin e çdo tentative për të prishur rendin dhe qetësinë pranë institucioneve ku ushtrojnë veprimtarinë struktura të reparteve ushtarake.

PLANIMETRIA CCTV E KATIT PËRDHE /CCTV GROUND FLOOR PLAN



Planimetria e katit perdhe

Sistemi i vëzhgimit me kamera është konceptuar të ketë mbikqyrje të ambienteve të brendshme dhe të jashtme. Të gjitha kamerat janë parashikuar të jenë kamera IP, dmth secila prej tyre do të ketë dhe identifikohet me IP të veten. Vendndodhja dhe pozicionimi i tyre është parashikuar që të plotësojë vëzhgim të gjithanshem. Përdorimi i kamerave, i lejon administratorit të sistemit të kryejë vëzhgim të imet dhe të detajuar të territoreve ose zonave të caktuara. Ky fakt mund të shfrytëzohet edhe në rast të kërkesave të mundshme të organeve ligjzbatuese të shtetit.

Eshte projektuar instalimi i 2 lloje kamerave me rezolucion te larte per ambientet brenda ne godine dhe ne ambient jasht saj.

Llojet e kamerave te instaluara jane:

- KAMERA IP E BRENDSHME, TIPI "BULLET"/ 5Mpx, me lente fikse 2.8mm, IP67


Detaj nr 1: Kamera tipi BULLET



- KAMERA IP E BRENDSHME, TIPI "DOME"/ 5Mpx,me lente fikse 2.8mm, IP67

Detaj nr 2: Kamera tipi DOME





Cilesia e regjistrimit te kamerave Dome dhe Bullet, ditën dhe natën.

IP Kamera 5mp DOME (indoor),2.8mm,IR40m

Karakteristikat e KAMERAVE	Vlerat specifike
Tipet & Nëntipet e Kamerave:	Indoor; Dome, <i>Kamera Indoor Dome</i>
Procesori i Figurës (“Image Sensor”):	Tipi sensorit: CMOS Sensor Madhësia e Sensorit: $1/X$, ku $X \leq 3$ Vlera X, për tu përcaktuar sipas projektit, por gjithmonë jo më e
Rezolucioni i Figurës:	M i
Ndjeshmëria Minimale ndaj Dritës:	40 IRE;
Tipi i Lenteve (“Lens Type”):	Fikse,
Largësia Fokale:	Për lente Fikse: 2.8mm
Diapazoni Dinamik i Ndjeshmërisë, Minimumi (Minimum Dynamic Range):	120 dB
Raporti Optik i Zmadhimit (“Optical Zoom Ratio”):	Lente fikse: N/A

Dedektim i Lëvizjes (“Motion Detection”):	Po
Alarm për rast Sabotimi të Kamas (‘‘Tampering Alarm’’):	Po
MultiStreaming:	<u>Min. Dual-Streaming</u>
Ushqimi Ushqimi:	<u>PoE ose PoE+ (802.3af ose 802.3at) për rrjet kamerash IP me distancë më të vogël se 90m;</u> <u>24 VAC ose 12/24 VDC, për rrjet kamerash IP me distancë</u>
Aksesorët për montim:	<u>Po, sipas tipit të kamerës dhe mënyrës së montimit</u>
Periudha e Mbulimit të Garancisë ‘‘Warranty’’:	<u>1 Vit</u>

IP Kamera 5mp BULLET (outdoor),2.8mm,IR40m

Karakteristikat e KAMERAVE	Vlerat specifike
Tipet & Nëntipet e Kamerave:	Outdoor; Dome, <i>Kamera Outdoor Dome</i>
Procesori i Figurës (“Image Sensor”):	Tipi sensorit: CMOS Sensor Madhësia e Sensorit: 1/X, ku $X \leq 3$ Vlera X, për tu përcaktuar sipas projektit, por gjithmonë jo më e vogël se 1/3: Shembull: 1/2.9” CMOS sensor
Rezolucioni i Figurës:	Minimumi. 5 MP;
Ndjeshmëria Minimale ndaj Dritës:	40 IRE;
Tipi i Lentëve (“Lens Type”):	Fikse,
Largësia Fokale:	Për lente Fikse: 2.8mm
Diapazoni Dinamik i Ndjeshmërisë, Minimumi (Minimum Dynamic Range):	120 dB
Raporti Optik i Zmadhimit (“Optical Zoom Ratio”):	Lente fikse: N/A
Ndriçimi Infra të Kuqe (“IR illuminators”):	<u>Kamera Outdoor:</u> Deri në 30m; me ndriçues Infra të Kuqe Inteligent.

Rezistenca Ndaj Shiut dhe Pluhurit:	<u>Outdoor:</u> IP67
Ditë/Natë:	Përshtatje e vërtetë për Ditë/Natë (“True Day/Night: automatic IR cut filter”).
Formati i Kompresimit të Videos:	H.265
Dedektim i Lëvizjes (“Motion Detection”):	Po
Alarm për rast Sabotimi të Kameras (“Tampering Alarm”):	Po
Temperatura e funksionimit:	<u>Outdoor (Të jashtme):</u> -40°C deri +60°C
MultiStreaming:	<u>Min. Dual-Streaming</u>

Ne ambientin teknik do të instalohen PC + ekranet e shikimit të pamjeve , paisja e komandimit të kamerave me fokus të levizshëm dhe një rack kryesor , ku do të vendosen paisjet e sistemit . Ne rack montohen :

- Paneli elektrik (parashikuar me 8 priza)
- Inverter 220 v AC / 48 v DC
- Bateri 48 v , 18 A/h
- 3 (tri) NVR (Network Video Recorder)
- Switch kryesor me 24 porta PoE (Power over Ethernet) dhe 4 porta SFP (Small Form-factor Pluggable)
- Pach Panel me 24 porta
- Panel ventilimi me termostat 19 inç


Ne pjeset e brendshme të ambjenteve, është ndertuar infrastruktura mbështetëse (referojuni planimetrisë për ndertimin e tubacionit).

NVR lidhen me switch-in kryesor . Ne secilin prej tyre instalohen nga 2 cope hard disc me kapacitet memorizimi 9 Tb (terabit - 10⁹) që lejon hapësirë të madhe kohore memorizimi të pamjeve të kamerave . Secili prej tyre regjistron në mënyrë të pavarur (duhet të programohen nga realizuesi i projektit) duke siguruar se bashku dhe në mënyrë të pavarur data base e duhur të regjistrimeve . Në rast problemi të njerit prej tyre , tjetri siguron data base e duhur .

Kamerat janë pozicionur përballë me hyrjen kryesore, në koridore, ku kendi i shikimit/regjistrimit është i qartë dhe në ambientet e jashtme. Është menduar pozicionimi i Rack-ut, switch, monitor, Ups në vende të cilat shërbejnë si ambient teknik. Në ambientet teknike gjithashtu janë projektuar instalime të kamerave, në mënyrë që siguria të jetë maksimale. Lidhja e kamerave me Switch dhe Rack do të realizohet nga Kabell Data FTP Cat.6.

Planimetri projekti


PLANIMETRIA CCTV E KATIT TË PARË /CCTV FIRST FLOOR PLAN



- Legende**
Legend
- Network video recorder, 32ch, 4 Mp
 - KAMERA IP E BRENDSHME, TIPI "BULLET"/
5Mpx, me lente fikse 2.8mm, IP67 INDOOR IP CAMERA "BULLET"
 - KAMERA IP E BRENDSHME, TIPI "DOME"/
5Mpx, me lente fikse 2.8mm, IP67 INDOOR IP CAMERA "DOME"
 - KABELL DATA CAT 6A TIPI FTP NE TUB PLASTIK, 020/
DATA CABLE, CAT 6A FTP, INSIDE PLASTIC PIPE 020
 - RACK IT /
RACK IT




RACK
 → CAMERA NUMBER / NUMRI I KAMERES
 → RACK NUMBER / NUMRI I RACK

FROM ABOVE/
VIENNGA SIPER
UPWARDS/
SHKON SIPER
FROM BELOW/
VIENNGA POSHTE
DOWNWARDS/
SHKON POSHTE



Jane paraqitur ne shkalle te qarte dhe te lexueshme te gjitha planimetrite.

Detaje teknike te Rack



Hartoi:
"Taulant" sh.p.k
Drejtuese Ligjore
Ing.Ditika Qatipi

RAPORT HIDROTEKNIK

EMERTIMI I PROJEKTIT:

**INVESTIME PËR TRANSFORMIMIN E ASETVE PUBLIKE ME
POTENCIAL ZHVILLIMI NË MODELE TË STANDARDIT MË TË LARTË TË ZHVILLIMIT:
PËRMIRËSIMI I SHËRBIMIT NË KOPSHTIN NR.4,
RRUGA "ADEM SHEME", SARANDË**

Hartuesi i projektit : B.O.E "Taulant" sh.p.k,
"Arkimade" sh.p.k &
"A.L.T.E.A Geostudio 2000" sh.p.k

Porositësi: Fondi Shqiptar I Zhvillimit



Permbajtja

I- TË PËRGJITHSHME.....	63
1. SISTEMI I FURNIZIMIT TE UJIT SANITAR (I FTOHTE / NGROHTE).....	67
1.1 Dimensionimi	67
1.2 Grupi i pompimit.....	68
1.3 Autoklava	70
1.4 Uji i ngrohte sanitar	72
1.5 Tipet e tubacioneve.....	73
1.6 Valvolat	74
1.7 Pajisjet Hidrosanitare	75
1.7.1 WC dhe kasete e shkarkimit.....	75
1.7.2 Lavamanet.....	77
1.7.3 Rubinetat.....	78
2. SISTEMI I SHKARKIMIT TE UJRAVE TE ZEZA.....	79
2.1 Dimensionimi	79
2.2 Materialet e tubave	80
2.3 Rakorderite e tubave	81
2.4 Piletat	82
2.5 Pusetat e ujrave te zeza	82
2.6 Kullimi i ujrave te shiut.....	83

I- TË PËRGJITHSHME

Kontraktori duhet qe me kujdesin e duhur dhe ne perputhje me dispozitat e kontrates te respektoje vizatimet e punimeve deri ne periudhen e percaktuar ne kontrate si dhe te kryeje perfundoje dhe te riparoje ndonje defekt te punimeve.

Kontraktori duhet te siguroje te gjithë personelin, materialet, impiantet, paisjet dhe te gjithë gjerat e tjera te nje natyre te perkohshme ose te perhershme qe kerkohen per vizatimin, kryerjen dhe perfundimin e punimeve si dhe per riparimin e ndonje defekti. Te gjitha sa u thane me lart do te jene te specifikuar ose nenkuptuar ne kontrate.

Te përgjithshme

Te gjitha materialet qe do te perdoren ne punime duhet te jene te reja, te modeleve me te fundit dhe te behen te gjitha përmirësimet e fundit te vizatimet dhe materialet, përveç se ne rastet kur kontrata parashikon dika tjetër.

Mjeshtëria e punimeve duhet te jete me e mira ne llojin e saj dhe e miratuar nga Inxhinieri.

Testimi i materialeve para përdorimit

Ndonjë ose te gjitha materialet e sjella nga Kontraktori për tu përdorur te punimet duhet ti nënshtrohet paraprakisht testeve qe specifikohen te standardi perkates, specifikimet ose sic shihet nganjehere e nevojshme nga Inxhinieri.

Kostoja e berjes se testeve tek materialet ose te mjeshteria e punimeve do te mbulohet nga cmimet e furnizimit te materialeve dhe sherbimeve perkatese.

Refuzimi

Materialet qe nuk i plotesojne kerkesat e specifikimeve do te refuzohen dhe furnitori do te njoftohet nga Inxhinieri.

Cilesia e Kontrollit

Kontraktori duhet te jete I pergjegjshme per cilesine e tij te kontrollit dhe duhet te kete nje staf te afte per te marre dhe pergatitur kampionet si dhe per te bere testet e nevojshme.

Lehtesirat e Testimit

Kontraktori duhet te identifikojë dhe te informojë me shkrim Inxhinierin per laboratorin ku mund te behen testimet per te siguruar qe cilesia e materialit dhe e punes po i permbahen specifikimeve te Materialeve.

Kostoja e berjes se testeve tek materialet ose te mjeshteria e punimeve do te mbulohet nga cmimet e furnizimit te materialeve dhe sherbimeve perkatese.

Paketimi

Te gjitha materialet duhet te paktohen ne nje menyre te atille qe te parandalohet demtimi ose prishja gjate transportit per ne destinacion. Paketimi duhet te jete i forte qe te duroje shkarkim te veshtire dhe ekspozim ndaj temperaturave ekstreme gjate tranzitit dhe magazimit. Cdo kuti ose arke amballazhi duhet te kete siper te shkruar ate cka ajo permban dhe emrin e adresen e prodhuesit, marresit si dhe daten e dergimit.

Transportimi i materialeve

Materialet e ndertimit duhet te mbahen dhe te transportohen sipas instruksioneve te prodhuesit.

Magazinimi i materialeve

Materialet e ndertimit do te ruhen ne vendet e miratuara nga Inxhinieri dhe ne cdo çast kontraktori duhet tu siguroje manaxhim te mire, mirembajtje dhe supervzim.

Furnizimi

Kontraktori mban pergjegjesi per furnizimin me materiale si dhe kryerjen e punimeve deri kur te miratohen perfundimisht nga Klienti ose Inxhinieri.

Programi i zbatimit

Brenda 30 ditesh pas fillimit te Kontrates, kontraktori duhet te pregatise dhe te dorezoje per miratim nga ana a Supervizorit nje program zbatimi te kontrates. Programi duhet te perfshije nje programim te detajuar te kohes duke patur parasysh nenkontraktoret e perfshire, kohen e inspektimeve dhe testeve specifike, nje pershkrim te metodave qe Kontraktori do te perdore dhe nje histogram te fuqise punetore.

Dokumentacioni

Vizatimet ne kantier te Prodhuesit

Vizatimet te cilat dorezohen nga Kontraktori per te dhene nje shpjegim te metejshe per punimet e perhershme dhe qe miratohen nga Inxhinieri do te jene vizatimet e prodhuesit, por saktesia e ketyre vizatimeve do te jete pergjegjesia e Kontraktorit.

Vizatimet ne kantier "Draft"

Kontraktori duhet te pregatise vizatime paraprake dhe ti dorezoje tek Inxhinieri. Vizatimet ne forme drafti duhet ti dorezohen Inxhinierit per miratim dhe pastaj te perfundohen sipas kerkesave ose permiresimeve qe behen. Kur te mbarojne, kontraktori duhet te pregatise dy kopje te vizatimeve draft te pakten 14 dite para se kontraktori te kerkoje nje procesverbal dorezimi per punimet perkatese.

Vizatimet draft duhet te tregojne rishikimet aktuale sic jane bere ne terren, duke perfshire te gjitha modifikimet qe jane bere gjate ecurise se punimeve.

Instrukcionet Manuale

Manualet e mirembajtjes te cilat japin te detajuar kerkesat e mirembajtjes per cdo detaj pune do te pergatiten nga Kontraktori dhe do ti dorezohen inxhinierit pas perfundimit te secilit sektor te punimeve si dhe dorezimit te atij sektori. Manualet e mirembajtjes duhet te kene formen e rene dakord me Inxhinierin. Duhet te behen 3 kopje ne gjuhen Angleze dhe Shqipe per secilin sektor te perfunduar.

Sigurria finale e cilesise dhe raporti i kontrollit

Raporti perfundimtar mbi cilesine e punimeve te perfunduara duhet te pergatitet nga Kontraktori ne fund te instalimeve duke u bazuar te raportet mujore, testet dhe inspektimet e bera gjate ndertimit dhe punimeve perfundimtare.

Kontraktori duhet te paguaje te gjitha shpenzimet per pergatitjen e ketij raporti final, pervec se ne rastet e percaktuara ndryshe ne Kontrate. Kontraktori bie dakord qe as berja e testeve dhe inspektimeve te Impianteve dhe Paisjeve ose ndonje pjese tjeter e punimeve, as vemendja e Punedhesisit ose Inxhinierit, as ceshtja e ndonje rezultati testi nuk do ti heqin Kontraktorit pergjegjesine ndja Kontrates.

Matjet

Ne perfundim te punimeve, Kontraktori duhet qe 14 dite para dorezimit per shfrytezim ti dorezoje Inxhinierit raportin perfundimtar mbi cilesine e punimeve. Koston per pergatitjen e raportit do ta paguaje Kontraktori.

Numri i punimeve individuale do te gjendet me ane te njesive matese te percaktuara te Programet/ Preventivat, Dokumentat e Kontrates dhe Kerkesat.

Punimet do te llogariten ne baze te vizatimeve, ne rastet kur puna e perfunduar korespondon me vizatimet, nese nuk percaktohen ndryshe te Kushtet e Pegjithshme dhe te Vecanta ose te Standartet Shqiptare, metoden e DIN 18300.

Vetem kur nuk parashikohet ndryshe te Kerkesat, sasite do te percaktohen nga punimet e bera ose sasine e materialit te perdorur, duke patur parasysh qe Inxhinieri nuk ka zgjedhur nje menyre tjeter matese.

Nderkohe kontraktori duhet ti kerkoje Inxhinierit te pergatise per dorezim objektin sipas dispozitave te Kerkesave, ne rastet kur eshte e pamundur te percaktohet cilesia dhe sasia. Nese Kontraktori nuk i ploteson kerkesat e dorezimit, ai eshte i vetmi qe mban pergjegjesi per ndonje shpenzim shtese qe behet ne lidhje me punimet e nevojshme per perfundimin e kushteve aktuale.

Sasite e matura dhe dimensionet do te shkruhen tek Ditari I Punimeve .Te gjitha matjet do te perfshihen dhe te gjitha vizatimet e bera per pjeset qe do te mbulohen pas perfundimit ose per ato te bera ndryshe nga vizatimi. Kontraktori 1 here ne muaj duhet ti dorezoje Inxhinierit per miratim Ditarin e Punimeve, si rregull para se te behet raporti mujor.

Te dhenat e hedhura tek Ditari i Punimeve duhet konfirmohen nga te dyja palet kontraktuese ne menyre qe pranohet si baze per efekt page sipas raportit mujor.

Te gjitha kerkesat per page te bazuara tek te dhenat qe nuk kane miratimin e te dyja paleve kontraktuese

mund te refuzohen nga Inxhinieri qe do te thote te perjashtuara nga raporti mujor.

Inxhinieri/ Perfaqesuesi I Klientit mund te refuzoje te miratoje/ konfirmoje te gjitha sasite e perdorura per punimet te cilat nuk jane bere ne perputhje me Kerkesat dhe Dokumentat e Vizatimit ne rastet kur Inxhinieri ka prova qe kerkesat nuk jane plotesuar.

Inxhinieri / Perfaqesuesi i Klientit mund gjithashtu te refuzoje te miratoje te gjithe sasine e perdorur per punimet e fshehura para se Inxhinieri te kontrolloje procedurat operative ,

dokumentat e materialit te future ne punime ose ne rastet kur Kontraktori ka vepruar ne menyre te atille qe mund te kercenoje zbatimin dhe sigurine e punimeve te perhershme.

Certifikatat dhe Pagesa

Punimet e kryera llogariten ne baze te raporteve te ndermjetem, mujore dhe perfundimtare ne perputhje me dispozitat e percaktuara te Kerkesat dhe Dokumentat e Kontrates.

Nese ka dyshime ne lidhje me cilesine e ndonje materiali ose pune, atehere Inxhinieri mund te pezulloje certifikimin gjate zhvillimit te testimi/ose inspektimi deri kur te tregohet qe materiali ose puna te perputhet me kerkesat.

Punimet shtese qe nuk perfshihen te Preventivat ne Kontrate do te llogariten mbi baza te Kushteve te Kontrates. Ne rastet kur dokumentat e Kontrates nuk permbajne dispozitat respektive, ateherepunimet shtese do te llogariten mbi baza te cmimit oer njesi per te cilin kane rene dakord te dyja palet gjate bisedimeve te kontrates. Inxhinieri duhet ti kerkoje Kontraktorit te jape nje ndryshim te detajuar te cmimit per njesi.

Te gjitha materialet e sjella per kryerjen e punimeve jane pasuri e Punedhesisit, I cili vendos se cfare duhet bere me keto furnizime.

Kampionet dhe Certifikatat e cilesise

Kontraktori duhet ti dorezoje Inxhinierit nje liste furnitresh nga te cilet ai propozon te bleje materialet e nevojshme per kryerjen e punimeve. Nese kerkohet nga Inxhinieri, Kontraktori duhet te dorezoje vizatimet dhe specifikimet teknike dhe te dorezoje kampionet e materialeve te zyres se Inxhinierit.

Te gjitha materialet duhet te perputhen me Standartet e ISO dhe Furnitori duhet ti dorezoje Inxhinierit Certifikaten e Cilesise te permbushjeve te dhena nga prodhuesit te materialeve te cilat jane konform kerkesave te standarteve dhe se te gjithe teste e specifikuara deri ketu jane kryer dhe se jane plotesuar te gjitha kerkesat e testeve. Vetem ne rastet kur thuhet ndryshe, botimi I fundit I Standarteve te permendura do te perdoret. Ne rastet kur nuk jepet ndonje specike e vecante per ndonje artikull ose material qe duhet te perdoret sipas kontrates, duhet te perdoren Standartet e duhura te ISO ose ekuivalenti i miratuar.

Kurdo qe kerkohen kampionet e Specifikimeve, Kontraktori duhet ti dorezoje per miratim Inxhinierit jo me pak se tre (3) kampionet per cecilin material dhe pa kosto shtese ndaj Punedhesisit.

Te gjithe kampionet duhet te etiketohen individualisht, ku te tregohen karakteristikat specifike fizike dhe emrat e prodhuesve per identifikimin dhe dorezimin te Inxhinieri per miratim. Sapo te merret miratimi I Inxhinierit, nje set kampionesh do te vulozet dhe te vihet data nga Inxhinieri dhe ti kthehet Kontraktorit me ane te Perfaqesuesit Teknik per nje ruajtje te mire ne zyren e terrenit deri kur te mbarojne punimet.

Vetem ne rastet kur percaktohet ndyshe, te gjitha ngjyrat dhe fibrat te materialeve te percaktuar do ti zgjedhe Inxhinieri nga ngjyrat dhe linjat e prodhimit standarte te prodhuesit.

Testet e Perfundimit te Punimeve

Raporti perfundimtar mbi cilesine e punimeve te perfunduara duhet te behet nga Kontraktori ne fund te ndertimit duke u bazuar te raportet e ndermjetme, testeve ose inspektimeve te bera gjate perfundimit te punimeve te instalimit .

Kontraktori duhet te paguaje te gjitha kostot dhe shpenzimet e bera ne lidhje me pergatitjne e ketij raporti perfundimtar, pervec se ne rastet e percaktuar ndryshe nga Kontrata. Kontraktori bie dakord qe as berja e testeve ose inspektimeve te Impianteve dhe Paisjeve ose ndonje pjese tjeter e punimeve, as pjesmarrja e Punedhenesit ose Inxhinierit, as ceshtja e ndonje certificate testi do ti heqin Kontraktorit ndonje nga pergjegjesite qe ka sipas Kontrates.

Dorezimi per shfrytezim

Miratimi i perkohshem

Miratimi I Perkohshem behet ne perfundim te ndertimit, qe do te thote ne perputhje me dispozitat e Dokumentave te Kontrates. Raporti perfundimtar qe Kontraktori I dorezon Inxhinierit/ Perfagesuesit te Klientit bashke me dokumeta plotesuese sic pershkruhet te dokumentat e Kontrates, do te jene dokumentat ku do te bazohet Inxhinieri/ Perfagesuesi i Klientit per te certifikuar pagesen dhe Punedhenesi ti paguaje shumen Kontraktorit, duke patur parasysh qe nuk ka ndonje diskutim ne lidhje me sasine ose cilesine e punimeve te bera.

Miratimi Perfundimtar

Miratimi Perfundimtar (qe ndryshe quhet Miratimi I Funkcionit) do te behet pas mbarimit te Periudhes se Pergjegjesise per Defektet. Do te krijohet nje komision per proceduren e Miratimit.

Pergjegjesia e defekteve

Vetem ne rastet kur percaktohet ndyshte nga kushtet e kontrates ose te specifikimet teknike periudha e pergjegjesise se defekteve eshte 2 vjet per punimet e instalimeve mekanike.

1. SISTEMI I FURNIZIMIT TE UJIT SANITAR (I FTOHTE / NGROHTE)

1.1 Dimensionimi

Dimensionimi dhe projektimi i te gjithë komponenteve dhe aksesoreve te sistemit te furnizimit dhe te shperndarjes te ujit te ftohte & ngrohete sanitar eshte realizuar duke marre ne konsiderate elementet e meposhtem:

- Skema e shperndarjes;
- Dimensionimi i rezervuarve te ujit per 48 ore autonomi;
- Percaktimi i prurjes nominale per çdo aparat h/sanitar dhe dimensionimi i tubove;

- Dimensionimi i tubacioneve magjistrale dhe ato te riqarkullimit;
- Prurja totale nominale;
- Prurja projektuese;
- Presioni i punes;
- Humbjet gjatesore njesi te presionit;
- Shpejtesia max. e qarkullimit te ujit;
- Dimensionimi i stacionit te pompimit (shpejtesi konstante);
- Dimensionimi i autoklaves;
- Dimensionimi i boilerave elektrike.

1.2 Grupi i pompimit

Grupi i pompimi te ujit eshte pjesa me rendesishme e sistemit. Ai eshte parashikuar te funksionoj me pompa dhe rezervuar zingato parametrat e te cileve jane llogaritur ne perputhje me diagramat ditore te nevojave per uje dhe konfiguracionit te rrjetit.

Ne funksion te tyre jane llogaritur presioni, prurja, fuqite e pompave si dhe specifikime teknike te tjera te paraqitura ne vizatim. Sistemi eshte projektuar duke parashikuar nje stacione pompimi, i cilat duhet te instalohen ne perputhje me kerkesat e projektit.

Stacioni automatik i furnizimit me uje sanitar

Stacioni eshte parashikuar qe te siguroje nje sasi uji qe perafersisht te mbuloje 48 ore autonomi dhe qe do te depozitohet ne rezervuarin zingato te llogaritur per kete qellim. Stacioni eshte parashikuar qe te furnizoj vetem me uje te ftohte sanitar te gjitha pajisjet h/sanitare qe jane instaluar ne kete objekt. Pajisjet e ketij stacioni jane instaluar ne ambientet e percaktuar ne projekt dhe jane te pershtatshem per shfrytezim, sherbime, kane ventilim te mjaftueshem dhe mungese lageshtire. Sipas skemes se zgjedhur ata duhet te vendosen ne bazamentin e soletes se nderteses.

Ky stacion eshte kompozuar nga nje pompe uji ne versionin e pompes centrifugale me shume shkalle vertikale. Pompa eshte vendosur ne nje bazament me konstrukcion llamarine çeliku te galvanizuar e mbeshtetur ne superte çeliku me gome antivibrante per te eliminuar vibrimet dhe zhurmat gjate pune se pompave. Suportet metalike nuk jane te lidhura me bazamentin ose muret e nderteses.

Pompa eshte pajisur me kolektoret e thithjes dhe dergimit qe jane te galvanizuar me veshje shtrese epoxidi. Ato kane ne perberje gjithashtu flusometer, manometer, valvola nderprerse, moskthimi si dhe panel elektrik komandimi dhe kontrollolli, si dhe presostate te taruar paraprakisht.

Grupi i pompimit te ujit sanitar INVERTER

Pompa eshte parashikuar pompe me pjese vitale prej çeliku inoks dhe kane keto karakteristika :

Trupi i pompes dhe motorit jane te lyer me resine ipoxide.

Trupi	:	Gize
Rrotori	:	Plastik
Pjeset komunikuese:		Gize
Boshti	:	X 20 Cr 13 (1.4021)
Kapak i boshtit	:	316 stainless steel
Hermetizues mekanik :		AQ1EGG (Standard)
Fluidi	:	Uje i paster
Prurja	:	19 m ³ /h
Presioni:		60 mkH ₂ O
Temperatura e punes:		(-10 to + 120°C)
Presioni i punes:		(max. 16 bar)
Motor		
Peshjtjella	:	3~400V/50Hz
Fuqia e motorrit :		2.83 kW
Rryma	:	6.5 A
Mbroitja	:	IP 54
Lidhjet e fllanxhave :		DN 65/ PN16





Grupi ka ne perberje panelin elektrik si dhe eshte i pajisur me kolektor zingato thithje dhe shkarkimi, presostat te presionit te ulet dhe te larte, galexhant elektrik, kuader elektrik per leshimin edhe mbrojtjen. Ai ka ne perberje rregullatorin elektronik per funksionimin ne menyre te shkallezuar te pompave (temporizator), si dhe per mbrojtjen dhe sinjalizimin e mbi/nen tensioneve, si dhe ne rastet e ndrim / mungese faze ne qarkun elektrik.

Grupi eshte i pajisur me valvol sigurie 10 bar. Ai duhet te vendoset ne menyre te tille qe te siguroje para dhe anash hapsiren e nevojshme per per operacione prove dhe mirembajtje.

Per te evituar rezonancat ose tensionet mekanike per jashtequndersine, duhet te instalohen suportet mbeshtetes. Rekomandohet te vendosen suportet mbeshtetesedhe tek tubot e kolektoreve te dergimit dhe te kthimit.

Bazamenti duhet te jete prej betoni dhe mberthimi duhet te kryhet me amortizatore

Pompa eshte e kontrolluar nga nje kuader elektrik independent, me lexim te lehte instrumentave te matjes dhe sinjalizimit.



Te dhenat e fabrikes

Prurja	12	m ³ /h
Lartesia	55	m
Lengu i pompuar	Uje i paster	
Temperatura e lengut	20	°C
Dendesia, densiteti	0.9982	kg/dm ³
Dendesi kinematike	1.001	mm ² /s
Presioni avullit	0.1	bar

Te dhenat e pompes

Marka, emri prodhimit		
Tipi	Grup pompash presioni	
Lloji ndertimit	Paisje shum pom peshe PN	
Tipi pompes	16	
Presioni dhene	20	
Temperatura min e lengut	20 °C	
Temperatura maks e lengut	40 °C	

Te dhenat hidraulike (pika e punes)

Prurja	12	m ³ /h
Lartesia	55	m
Shpejtesi	3500	1/min

Material/permistop

Trup, karkase	1.4301
Helikat	1.4301
Foleja, dhoma e helikave	1.4301
Mantel presioni	1.4301
Bosht	inoks 316 grade
Tubacion	1.4571

Permasat

				mm			
L	600	H1	170				
L1	300	H3	90				
P	920	X	600				
P1	764						
P3	450						
H	1375						

Ana e thithjes	R 3 PN10/ PN 10
Ana dalse e presionit	R 3 PN16/ PN 16
Pesha	179.8 kg

Te dhenat e motorit/pompes

Fuqja e dhene	4	kW
Shpejtesi e dhene	2970	1/min
Tensioni i dhene	3~400 V, 50 Hz	
Rryma maks e thithjes	10.2	A
Grada/shkalla e mbrotjeje	P 55	
Toleranca e lejuar e tensionit	+/- 10% ,	

Nr i artikullit te modelit standart 2523137

1.3 Autoklava

Autoklava është një paisje e cila montohet pran pompes se ujit sanitar, e cila shërben për të rritur presionin e ujit në ndërtesa.

Presioni i ujit mund të ndryshojnë gjatë gjithë ditës në bazë të konsumit, praninë e ndonjë

rrjedhje në tubacioneve dhe presion në pikën e erogacionit. Në përgjithësi, presioni i ujit është një bar pak. Një bar (1 km/cm²) mund të ushtrojë presion të mjaftueshme për të ngritur ujin në një lartësi kolonë prej rreth 10 metra. Rrjedha e ujit mund të jetë e pamjaftueshme dhe e paqëndrueshme në vendet e larta, në raste të tilla është e nevojshme për të përdorur një autoclave.

Autoklava është një enë nën presion, ku pompa e karikon atë në baze të takimit të stakimeve për të marrë një presion më të madh se ai i rrjetit të ujit. Pasi arrihet presioni i dëshiruar, pompa fiket dhe sistemi e mban të karikuar vetë autoklava

Materiali i autoklaves është prej çeliku me karbon , i mbrojtur me një shtresë epoxidi në ngjyrë blu RAL 5015, e polimerizuar .

Te dhënat teknike janë prezantuar si më poshtë :

Presioni max. i punës :	16 bar
Presioni i ngarkimit :	1.5 bar
Kapaciteti :	500 lit
Diametri :	650 mm
Lartësia:	1865 mm
Lidhjet :	1¼”(DN32)

1.4 Uji i ngrohte sanitar

Uji i ngrohte sanitar është i kompozuar të realizohet prej prodhuesit të energjisë termike që në rastin tonë do të jenë boilerat elektrike si dhe tubacioneve e pajisjeve të tjera për furnizimin dhe rregullimin tij.

Boiler elektrik (shkëmbyesi i nxehtësisë)



Boiler Elektrik Vertikal kap. 80 lit



Boiler Elektrik Vertikal kap. 50 lit

Prodhuesi i ujit te ngrohte sanitar eshte perzgjedhur per te siguruar furnizim gjate gjithë dites. Madhesia e tij eshte kalkuluar ne funksion te nevojave per uje sanitar dhe karakteristikat e tij duhet te jene percaktuar qarte ne çertifikaten e kualitetit leshuar nga prodhuesi. Karakteristikat teknike kryesore jane parqitur ketu me poshte:

Boiler Elektrik Vertikal kap. 80 lit

Tipi :	Boiler vertikal i termoizoluar me shkëmbyes inoksi te zmontueshem Izolimi
:	Shtrese fleksibile shkume polyuretan 50 mm trashesi;
Veshja e jashtme :	Çeliku me karbon, i mbrojtur me nje shtrese epoxidi ne ngjyre te bardhe e polimerizuar;
Mbrojtja :	Sistemi i mbrojtjes katodike, anode magneze e thjeshte;
Kapaciteti :	80 lit, Pmax 8 bar, Tmax 95 °C.

Boiler Elektrik Horizontal kap. 50 lit

Tipi :	Boiler horizontal i termoizoluar me shkëmbyes inoksi te zmontueshem;
Izolimi :	Shtrese fleksibile shkume polyuretan 50 mm trashesi;
Veshja e jashtme :	Çeliku me karbon, i mbrojtur me nje shtrese epoxidi ne ngjyre te bardhe e polimerizuar;
Mbrojtja :	Sistemi i mbrojtjes katodike, anode magneze e thjeshte;
Kapaciteti :	50 lit, Pmax 8 bar, Tmax 95 °C.

1.5 Tipet e tubacioneve


Sistemi i ujit te ngrohte sanitar do te sherbeje per te siguruar ujin e ftohte dhe te ngrohte nga stacioni i pompimit tek kolektoret dhe mbas kesaj te siguroje shperndarjen e ujit ne pajisjet e ambienteve sanitare. Sistemi i tubove te ujit sanitar do te plotesoje kerkesat e normave dhe standarteve te percaktuar dhe seleksionuar qysh ne fazen e projektimit prej stafit inxhinierik si dhe te kerkesave paraprake te investitorit. Tubo e ketij sistemi jane ndare ne funksion te materialit te tyre si me poshtë.

Tub PPR

Tubot e kondensimit do te jene pjeserisht me tubo polipropileni PPR me keto karakteristika:

Densiteti i PPR:	0,9 g/cm ³
Temperatura e saldimit:	146 grade Celsius
Percjellshmeria termike ne 22 grade:	0,23 W/mK
Koeficienti i zgjerimit linear:	1,5 x 0,0001 K
Elasticiteti ne 22 grade:	670 N/mm ²
Rezistenca ne rjedhje ne 22 grade:	22 N/mm ²
Rezistenca ne shkaterim ne 22 grade :	35 N/mm ²

Menyra e shtrirjes se tubave, kuotat, shtresat e ndryshme per mbeshtetjen dhe mbulimin e tubacioneve jane dhene ne detajet teknike e projektit.



Te gjitha punet e lidhura me instalimin dhe vendosjen e tubacioneve te ujit ne objekt, duhet te behen dhe sipas kerkesave teknike te supervizorit dhe te projektit. Nje katalog me te dhenat teknike , çertifikatat e cilesise, origjines se materialit, garancia minimale prej 3 vjetesh dhe çertifikata e testimi te bere nga prodhuesi, do t'i jepet per shqyrtim supervizorit per nje aprovim para se te vendoset ne objekt.

1.6 Valvolat

Valvolat jane pajisje te veçanta qe do te perdoren per kontrollin e rrjedhjes ne tubacionet e ujit. Me ane te saraçineskave mund te ndryshohet madhesia e prurjes qe i jepet pjeses tjeter te tubit ose nderprerjen e plote te rrjedhjes. Valvolat mund te jene me material bronxi, gize ose çelik inoxi. Ato jane te tipit me sferë ose me porte, me bashkim, me filetim ose me flanaxha. Valvolat sipas menyres se bashkimit me tubat I ndajme ne lloje: me flanaxhe dhe me fileto.

Valvolat qe perdoren ne nje linje ujesjellesi duhet te perballojne nje presion 1,5 here me teper se presioni i punes. Ato duhet te perballojne nje presion minimal prej 10 bar.

Valvolat duhet te sigurojne rezistence perfekte ndaj korrozionit, rezistence ndaj agjenteve kimike, peshe te lehte, mundesi te thjeshte riparimi dhe transporti, jetegjatesi mbi 25 vjeçare dhe qendrueshmeri ndaj goditjeve mekanike.

Ne raste te veçanta me kerkese te projektit ose te supervizorit perdoren edhe kundralvalvolat qe jane valvola te cilat lejojne levizjen e ujit vetem ne nje drejtim. Keto duhet te vendosen ne tubin e thithjes se pompave apo ne tubin e dergimit te tyre. Gjithashtu ato vendosen ne hyrje te nderteses per te bere bllokimin e ujit qe futet.

Ato jane te tipit me porte, e cila me ane te nje çerniere hapet vetem ne nje drejtim. Ne rast se uji rrjedh ne drejtim te kundert me ate qe kerkohet, behet mbyllja e saj me ane te çernieres.

Te gjitha punet e lidhura me instalimin dhe vendosjen e tyre ne objekt duhet te behen sipas kerkesave teknike te supervizorit dhe te projektit.

Nje model i valvoles qe do te perdoret se bashku me çertifikaten e cilesise, çertifikaten e origjines, çertifikaten e testimi dhe te garancise do t'i jepet per shqyrtim Supervizorit per nje aprovim para se te vendoset ne objekt

1.7 Pajisjet Hidrosanitare

1.7.1 WC dhe kaseta e shkarkimit

Ne ambientet e larjes apo dhomat e tualetit parashikohet edhe vendosja e WC-ve. Ato jane me material porcelani me te dhenat e standarteve teknike nderkombetare dhe duhet te percaktohen ne projekt nga projektuesi. Ato mund te jene te tipit oriental ose alla frenga. Ne shkolla rekomandohen te tipit oriental WC, ku vendoset direkt ne dysheme dhe montohet llaç çimento sipas udhezimeve te dhena nga supervizori.

WC tip alla frenga perdoren ne kopshte dhe per personelin pedagogjik dhe antikapatet, fiksohen ne dysheme ose ne mur me fasheta tunxhi, vida dhe tapa me fileto pa ndeprere veshjen me pllaka te murit. Para fiksimit te tyre duhet te behet bashkimi me tubat e shkarkimit te ujrave. WC mund te jete me dalje nga poshte trupit te saj ose me dalje anesore ne pjesen e pasme te WC. Ne WC me dalje anesore tubi i daljes duhet te jete ne lartesine 19 cm nga dyshemeja.

Ne pjesen me te ulet te siperfaqes se gropes mbledhese eshte nje vrime me diameter minimal 90 mm. Pjesa e siperme e WC-se eshte ne forme vezake ose rrethore ne varesi te kerkeses se projektit, llojit dhe modelit

te tyre. WC tip alla frenga jane me lartesi 38-40 cm dhe vendosen sipas kerkeses se projektit dhe Supervizorit. Distanca horizontale e vendosjes se tyre nga pajisjet e tjera hidrosanitare (Lavaman,bide, etj) duhet te jete te pakten 30 cm.

WC-ja duhet te siguroje percjellshmeri te larte te ujrave, rezistence ndaj goditjeve mekanike, mbrojtje izoluese ndaj ujrave, rezistence ndaj korrozionit dhe agjenteve kimike, lehtësi gjate punes ne to dhe mundesi te thjeshta riparimi.


WC-ja lidhet me tubat e shkarkimit te ujrave me ane te tubit ne forme sifoni. Tubi i lidhjes se WC me tubat e shkarkimit duhet te jete PVC me te njejtat karakteristika teknike te tubave te shkarkimit te ujrave. Diametri i tyre do te jete ne funksion te daljeve te WC (zakonisht ato jane 100-110 mm).

WC-ja lidhet me sistemin e furnizimit me uje me ane te kasetes se shkarkimit e cila mund te instalohet direkt mbi WC ose ne mur e ndare nga WC-ja. Kjo varet nga lloji i ketyre pajisjeve. Kasete e shkarkimit vendoset ne lartesine rreth 1,5 m lart nga dyshemeja (rasti kur eshte e ndare). Ajo mund te jete porcelani, metalike ose plastike. Lloji i materialit te saj duhet te percaktohet ne projekt. Tubi i shkarkimit fiksohet ne mur me fasheta te forta xingato, me vida dhe tapa me fileto ne çdo 50 cm.

Te gjitha punet e lidhura me instalimin dhe vendosjen e WC duhet te behen sipas kerkesave teknike te supervizorit dhe te projektit. Bashkimi i WC-ve me tubat e shkarkimit duhet te behet me mastik te pershtatshem per tuba PVC, i rekomanduar nga prodhuesi i tubave.

Nje model i WC qe do te perdoret sebashku me çertifikaten e cilesise, çertifikaten e origjines, çertifikaten e testimi dhe te garancise do t'i jepet per shqyrtim Supervizorit per nje aprovim para se te vendoset ne objekt. Te dhenat teknike te WC duke perfshire edhe modelin e tij, emrin e prodhuesit, standartit qe i referohen, viti i prodhimit, etj duhet te jepen ne katalogun perkates qe shoqeron mallin. Supervisor mund te beje testimet plotesuese per te dhenat fizike-mekanike te tyre.

Ne figurat e meposhtme paraqiten dy tipe WC, ajo tip alla Turke dhe ajo tip alla Frenga



1.7.2 Lavamanet

Ne ambientet e larjes apo dhomat e tualetit, gjithmone duhet te parashikohen pajisjet hidrosanitare perkatese (lavamanet) te cilat sherbejne si vende per larjen e duarve dhe fytyres se femijeve. Lavamanet mund te jene metalike, porcelani, muri tulle i suvatuar e veshur me pllaka ose te montuar ne veper. Lloji i materialit perberes te tyre duhet te percaktohet ne projekt nga projektuesi.

Lavamanet duhet te sigurojne percjellshmeri te larte te ujrave, rezistence ndaj goditjeve mekanike, mbrojtje izoluese ndaj ujrave, eliminim te zhurmave gjate punes, rezistence ndaj korrozionit dhe agjenteve kimike, lehtësi gjate punes ne to dhe mundesi te thjeshta riparimi.

Lavamanet e porcelanit dhe mbeshtetësja e tyre fiksohen ne mur me fasheta tunxhi, vida dhe tapa me fileto pa nderprere veshjen me pllaka te murit. Pas fiksimit te saj ne mur duhet te behet vendosja e rubinetave me tunxh te kromuar mbi lavaman dhe bashkimi i lavamanit me tubat e kanalizimit te sifonit dhe tubat e shkarkimit te ujrave. Njekohesisht lavamani duhet te pajiset edhe me pileten e tij metalike. Pileta

duhet te vendoset ne pjesen me te ulet te siperfaqes se gropes mbledhese ku eshte hapur nje vrime me permasat e piletes. Lavamani ka nje grope mbledhese me permasa 40/60 x 36-45 cm ne varesi te llojit dhe modelit te zgjedhur. Permasat e lavamanit jane ne varesi te llojit dhe modelit te tyre Lavamanet vendosen ne lartesi 75- 85 cm sipas kerkeses se projektit dhe Supervizorit. Distanca horizontale e vendosjes se tyre nga pajisjet e tjera hidrosanitare (bide,WC, etj) duhet te jete te pakten 30 cm

Lavamanet lidhen me tubat e shkarkimit te ujrave me ane te piletes, tubit ne forme sifoni prej materiali PVC-je. Lidhja e mesiperme mund te behet me tridegeshe te pjerreta nen nje kend 45 ose 60 grade. Tubi i lidhjes duhet te jete PVC me te njejta karakteristika


teknike te tubave te shkarkimit te ujrave. Gjatesia e ketyre tubave eshte 20 - 40 cm. Diametri i tyre do te jete ne funksion te daljeve te piletes ku jane vendosur.

Lavamanet lidhen me sistemin e furnizimit me uje me ane te dy tubave fleksibel me gjatesi 30 - 50 cm dhe diameter 1/2 ", te cilet bejne lidhjen e rubinetit me tubat e furnizimit me uje te ngrohte dhe ujit te zakonshem. Ne vendin e lidhjes se rubinetit me lavamanin duhet te vendosen gomina te pershtatshme, per te mos bere lejimin e rrjedhjes se ujrave.

Te gjitha punet e lidhura me instalimin dhe vendosjen e tyre ne objekt behen sipas kerkesave teknike te supervizorit dhe te projektit. Bashkimet e lavamanit me tubat e shkarkimit duhet te behen me tubat perkatese dhe me mastik te pershtatshem per tuba PVC i rekomanduar nga prodhuesi i tubave.

Nje model i lavamanit qe do te perdoret sebashku me çertifikaten e cilesise, çertifikaten e origjines, çertifikaten e testimi dhe te garancise do ti jepet per shqyrtim Supervizorit per nje aprovim para se te vendoset ne objekt. Supervisor mund te beje testimet plotesues per te dhenat fizike-mekanike te tyre.

Ne figuren e meposhtme paraqitet nje lavaman porcelani, i cili eshte inkastruar ne mur.



1.7.3 Rubinetat

Rubinetat jane pajisje te veçanta qe perdoren per kontrollin e rrjedhjes ne tubacionet e ujit. Ato vendosen ne pajisjet hidrosanitare perkatese (lavamane, lavapjata ose bide) dhe mund te jene te thjeshta (perdoren vetem per ujin e pijshem) ose te perbera (perdoren per sistemet e ujit te ftohte dhe te ngrohte). Me ane te rubinetave mund te ndryshohet madhesia e prurjes qe del ne pajisjen hidrosanitare si dhe mund te behet edhe rregullimi i temperatures se ujit qe perdoret. Rubinetat mund te jene me material bronxi, gize ose te nikeluara. Ato jane te tipit me sfero ose porte.

Grupi i Rubinetes eshte tip me lidhje tubi, ose dy lidhje rrethore, i cili perbehet prej pjeseve te meposhtme:

Trupi prej gize ose bronxi. Forma dhe lloji i trupit te rubinetes jane te ndryshme. Ngjyra, forma dhe tipi jane te percaktuara ne projekt ose duhet te percaktohen nga Investitori.

- 1.7.3.1 Disku ose sfera, qe duhet te siguroje mbylljen dhe hapjen e rubinetes per ujin e ftohte ose te ngrohte duke bere edhe rregullimin e sasise qe del nga rubineta. Ato jane me material çeliku ose bronxi dhe duhet te jene rezistence ndaj korrozionit, goditjeve mekanike, etj
- 1.7.3.2 Leva e cila lidhet me boshtin e rrotullimit dhe realizon hapjen ose mbylljen e diskut.
- 1.7.3.3 Filtri i ujit i cili vendoset me filetimit ne dalje te rubinetes dhe siguron pastrimin e ujit nga lende te ndryshme minerale apo kriprat qe shoqerojne ujin e pijshem
- 1.7.3.4 Tubat fleksibel me gjatesi 30-50 cm te cilet bejne lidhjen e rubinetes me tubat e furnizimit me uje. Tubat fleksibel kane diametrin 1/2" ose 3/8" ne varesi te llojit te rubinetes dhe te tubave

Ne vendin e bashkimit te rubinetave me pajisjen hidrosanitare dhe me tubat lidhes duhet te vendosen gominat perkatese te cilat nuk lejojne rrjedhjen e ujit.

Rubinetat duhet te sigurojne rezistence perfekte ndaj korrozionit, rezistence ndaj agjenteve kimike, pamje sa me te mire, mundesi te thjeshte riparimi, jetegjatesi dhe qendrueshmeri ndaj goditjeve mekanike. Rubinetat duhet te perballojne nje presion 1,5 here me teper se vete tubat e linjes. Ato duhet te perballojne nje presion minimal prej 10 atm.

Te gjitha punet e lidhura me instalimin dhe vendosjen e rubinetave ne pajisjet hidrosanitare te behen sipas kerkesave teknike te supervizorit dhe te projektit.

Nje model i rubinetes se duhur qe do te perdoret sebashku me çertifikaten e cilesise, çertifikaten e origjines, çertifikaten e testimi dhe te garancise do ti jepet per shqyrtim Supervizorit per nje aprovim para se te vendoset ne objekt. Te dhenat mbi diametrin e jashtem te rubinetit, modelin e tij, presionin, emrin e prodhuesit, standartit qe i referohen, viti i prodhimit, etj duhet te jepen ne katalogun perkates qe shoqeron mallin. Supervizori mund te beje testimet plotesues per cilesine e tyre si dhe presionin qe durojne pas instalimit (Testi i presionit behet me 1.5 here te presionit te punes).

2 SISTEMI I SHKARKIMIT TE UJRAVE TE ZEZA

2.1 Dimensionimi

Dimensionimi dhe projektimi i te gjithë komponenteve dhe aksesoreve te sitemit te shkarkimit te ujrave te zeza do te kryhet duke marre ne konsiderate te gjithë elementet te percaktues si me poshte:

- Skema e shpërndarjes (shkarkimet e brendshme te pajisjeve H/S, kolonat, kolektoret, pusetat);
- Percaktimi i fluksit nominal te shkarkimeve per çdo pajisje H/S;
- Percaktimi i fluksit projektues te shkarkimeve;

- Vizatimet dhe dimensionimet e shkarkimeve te brendshme te ujrave te zeza;
- Vizatimet dhe dimensionimet e shkarkimeve te kolonave te ujrave te zeza;
- Vizatimet dhe dimensionimet e kolonave te balancimit te presionit te ujrave te zeza;
- Vizatimet dhe dimensionimet e kolektoreve te shkarkimeve te brendshme;
- Vizatimet dhe dimensionimet e tubacioneve te shkarkimit te ujrave te shiut;
- Vizatimet dhe dimensionimet e kolektoreve te jashtem;
- Vizatimet dhe dimensionimet e pusetave te ujrave te zeza.

Dimensionimi i tubove do te jete ne vartesi te fluksit te llogaritur te ujrave te zeza, shpejtesise se qarkullimit dhe pjerresise se tyre etj. Shpejtesia duhet te jete $1.0 \div 1.2$ m/sec dhe pjeresia e tubove ne kufijte $(0.5 \div 0.8)$ %.

Gjatesia e tubove do te jete $6 \div 10$ m. Diametrat dhe trashesite do te jene ne perputhje me te dhenat e projektit. Ne diametrat e jashtem te çdo tubi duhet te jene te stampuar karakteristikat sikurse presioni, fabrika prodhuese, viti i prodhimit etj.

2.2 Materialet e tubave

Per shkarkimet e ujrave brenda ambienteve do te perdoren tuba plastike RAU – PP (polipropilen i termostabilizuar ne temperature te larta) qe plotesojne te gjitha kerkesat e cilesise sipas standartit EN 1451 (Kerkesa per testimin dhe kualitetin tubove). Ata jane disenjuar ne perputhje me standartin EN 12056.

Keto tuba duhet te sigurojne rezistence perfekte ndaj korrozionit, rezistence te larte ndaj agjenteve kimike, peshe te lehte, mundesi te thjeshta riparimi, transporti, instalim te thjeshte dhe te shpejte si dhe jetegjatesi mbi 30 vjet.

Tubat e shkarkimit duhet te vendosen ne te gjitha lartesine e nderteses, ne formen e kollonave, ne ato nyje sanitare ku aparatet jane me te grupuara dhe mundesisht sa me afer atyre nyjeve qe mbledhin me shume ujera te ndotura dhe ndotje me te medha.

Tubat e shkarkimit lidhen me pajisjet sanitare ose grup pajisjesh ne çdo kat me ane te tubave te dergimit. Lidhja e tubave te dergimit me kollonat e shkarkimit duhet te behet me tridegeshe te pjerreta nen nje kend 45 ose 60 grade. Tubat e dergimit mund te shtrohen anes mureve, mbi ose nen solete duke mbajtur parasysht kushtet e caktuara per montimin e rrjetit te brendshem te kanalizimeve. Gjatesia e ketyre tubave nuk duhet te jete me teper se 10 m. Diametri i tyre do te jete ne funksion te daljeve te pajisjeve sanitare qe jane vendosur.

Çdo kollone vertikale e shkarkimit pajiset me pika kontrolli te cilat duhet te vendosen ne



çdo dy kate duke filluar nga pjesa e poshtme e kollones.

Tubat e shkarkimeve që do të përdoren në ambientet e jashtme, janë tuba të PP të trullësuar, me specifikime teknike si më poshtë:



Specifikimet teknike:

Materiali: PP (*Polipropilen*) në të zezë dhe të verdhë

Përmasat:

- D [mm]: 125÷600

- L [m]: 3, 6

Temperatura maksimale operative [° C]: 95

Klasa tub ngurtësi [kN / m²]: SN 4, SN 8

2.3 Rakorderite e tubave

Për lidhjen e tubave të shkarkimit me njëri tjetrin si dhe me pajisjet sanitare apo grupet e tyre do të përdoren rakorderite përkatëse me material plastik RAU – PP, që plotësojnë të gjitha kërkesat e cilësisë sipas standartit EN 1451 (Kërkesa për testimin dhe kualitetin tubave).

Keto rakorderi (pjesë bashkuese) duhet të sigurojnë rezistencë ndaj korrozionit, rezistencë të lartë ndaj agjentëve kimikë, peshë të lehtë, mundësi të thjeshtë riparimi, transporti dhe instalimi, të thjeshtë dhe të shpejta.



Përmasat (diametri) e tyre do të jenë në funksion të sasisë llogaritore të ujit të ndotur, llojit të pajisjeve sanitare, shpejtësisë së levizjes së ujit dhe diametrave të tubave përkatës. Gjate llogaritjeve, shpejtësia e levizjes së ujit duhet të merret 1-2 m/sek kurse shkalla e mbushjes do të jetë 0.5-0.8 e seksionit të tubit.

Diametri dhe spesori i tyre duhet te jene sipas te dhenave ne vizatimet teknike. Te dhenat mbi diametrin e jashtem, gjatesite, presionin, emrin e prodhuesit, standartit qe i referohen, viti i prodhimit, etj. duhet te jepen te stampuara ne çdo rakorderi.

Diametri i rakorderive duhet te jete i njejte me diametrin e tubit te shkarkimit ku do te lidhet dhe ne asnje menyre me i vogel se tubi me i madh i dergimit te ujrave te ndotura qe lidhet me te. Ne rastet e ndryshimit te diametrit te tubave te shkarkimit dhe te dergimit, rakorderite duhet t'i pershtaten secilit prej tyre.

2.4 Piletat

Per shkarkimet e ujrave te dyshemeve do te perdoren piletat me kapak grille inoksi DN 50, qe plotesojne te gjitha kerkesat e cilesise sipas standartit EN 1451 (Kerkesa per testimin dhe kualitetin tubove.

Piletat mund te jene me material plastik, inoksi dhe bronxi.

Piletat duhet te sigurojne percjellshmeri te larte te ujrave, rezistence ndaj korrozionit dhe agjenteve kimike, mundesi te thjeshta riparimi, transporti dhe bashkimi.

Piletat e shkarkimit duhet te vendosen ne pjesen me te ulet te siperfaqes ku do te mblidhen ujrart. Zakonisht ato nuk vendosen ne afersi te bashkimit te dyshemese me muret, por sa me afer mesit te dyshemese.

Piletat e shkarkimit lidhen me kollonat e shkarkimit me ane te nje tubi PP. Lidhja e piletave me kollonat e shkarkimit mund te behen me tridegeshe te pjerrreta nen nje kend 45 ose 60°. Tubi i lidhjes duhet te jete PVC me te njejtat karakteristika teknike te tubave te shkarkimit te ujrave. Gjatesia e ketyre tubave eshte 20 - 30 cm. Diametri i tyre do te jete ne funksion te daljeve te piletes ku jane vendosur. Ne rastet e ndryshimit te dimaterit te piletes me ate te tubit te dergimit do te perdoren reduksionet perkatese.

2.5 Pusetat e ujrave te zeza

Te gjitha tipet e pusetave te larte permendura mund te jene me mure te tilla me elemente te parafabrikuara betoni, ose me beton te derdhur ne vend.

Materiali nga i cili eshte prodhuar si korniza ashtu edhe kapaku duhet te jene prej gize. Pusetat duhet te plotesojne kerkesat e meposhtme teknike:

- Ngarkesen e mbajtjes, te jashtme;
- Presionin e dheut;
- Presionin e ujit.

Dimensionet e pusetave kalkulohen ne funksion te prurjeve jane percaktuar n projektuesi ne vizatimet perkatese.



Gjithashtu edhe dimensionet e kolektoreve qe shkarkojne ujrato e zeza dhe ato te shiut jane kalkuluar dhe dimensionuar ne funksion te prurjeve dhe materiali i tyre eshte perzgjedhur PE i rudhosur ne siperfaqen e jashteme dhe i lemuar ne ate te brendshme me dimensione qe variojne nga 200 - 250 mm.

2.6 Kullimi i ujrave te shiut

Nje pike e rendesishme gjate projektimit te nje ndertimi eshte edhe kullimi i ujrave te shiut, qe grumbullohen nga çatite ose tarracat.

Ujrat e shiut do te kene nje kanalizim te ri perreth ndertese dhe me pas duhet te kullojne ne kanalizimin e pergjithshem te godines e me tej ne ate ekzistues te zones .

Çative, ballkoneve, taracave dhe elementeve te tjera te ndertimit, duhet tu hiqet uji me nje sistem te perbere prej pjerrësish drejt piletave te shkarkimit.

2.6.1 Pusetat e ujrave te shiut

Per grumbullimin e ujrave te shiut do te perdoren puseta te tipit mbledhese me konstruksion te parafabrikuar polietilene te papershkueshem nga uji dhe me kapak gize. Ato per nga forma e ndertimit mund te jene katrore, drejtkendeshe ose rrethore ndersa nga menyra e organizimit te tyre mund te jene me nje dhome me dy ose me shume dhoma.

Pusetat e ujrave te shiut duhet te jene ne forme rrethore me thellesi jo me pak se 60 cm. Permasat jane 40 x 25 mbuluar me kapak zgate hekuri ose gize. Te çarat me kapakun prej zgate jane nga 25 deri 35 mm per te ndaluar plehrat si dhe per te mundesuar kullimin e ujrave.

Pusetat e hyrjes material PE – polietileni, menyra e prodhimit me metodën e derdhur me rotacion.

Inspektimi i pusetave PE tregtohet nga ITC-ja, duhet te jenë prodhuar në përputhje me standarde evropiane Pren 13.598 cili përfshin sistemet e tubacioneve plastike për kullimit dhe kanalizimit. Baza e mirë është ndërtuar në përputhje me DIN V 4.034-1.

Karakteristikat pozitive te pusetave PE, jane si me poshte:

- Objektet prodhuar pa përdorimin e presionit janë gjithmon të përsosura;
- Nuk ka saldime;
- Eshte e mundur edhe të prodhohen objekte të madhësisë të madha;
- Aftësia për të prodhuar objekte të çdo formë.



Projektuesi
“Taulant” sh.p.k
Drejtuese Ligjore
Znj. Ditika Qatipi

RAPORT I SISTEMEVE TE INSTALIMEVE MEKANIKE NORMA DHE PERCAKTIME TEKNIKE

EMERTIMI I PROJEKTIT:

INVESTIME PËR TRANSFORMIMIN E ASETEVE PUBLIKE ME
POTENCIAL ZHVILLIMI NË MODELE TË STANDARDIT MË TË LARTË TË ZHVILLIMIT:
PËRMIRËSIMI I SHËRBIMIT NË KOPSHTIN NR.4,
RRUGA “ADEM SHEME”, SARANDË

Hartuesi i projektit : B.O.E “Taulant” sh.p.k,

“Arkimade” sh.p.k &

“A.L.T.E.A Geostudio 2000” sh.p.k

Porositësi: Fondi Shqiptar I Zhvillimit



ALTEA
GEOSTUDIO



Sistemi i Kondicionimit dhe ventilimit (HVAC)

- 1.1 Hyrje
- 1.2 Kondita te projektimit
- 1.3 Humbjet e nxehtësisë
- 1.4 Përzgjedhja e sistemit dhe tipologjia
- 1.5 Ambjenti teknik
- 1.6 Terminali ngrohse ftohese fancoil
- 1.7 Ventilimi i tualeteve
- 1.8 Aspirimi i kuzhines

Sistemi i Ngrohjes dhe Kondicionimit

1.1 Hyrje

Ambientet e kopeshtit jane te perbere nga zona me tipologji te njejte, ne te cilat ushtrohen aktivitete qe dallohen shume pak me njera tjetren, te cilat kane te njejtin qellim te perbashket per sa i perket sigurimit te nje komoditeti banimi.

Keto kerkesa jane parapare ne propocion me standartet e jeteses si dhe me ndikimin e tyre ne koston e ndertimit.

1.2 Karakteristika arkitektonike

Ambientet dhe strukturat arkitektonik eshte e njejte ne funksion te dimensionimit te tyre dhe lokalizimit ne projekt. Konfigurimi eshte i kompozuar ne dy zona te ndryshme nga pikpamja e konstruksionit, funksionalitetit dhe pajisjeve te instaluar.

- Klasat ;
- Banjot;

1.2 Konditat e projektimit

Konditat e komfortit termoigrometrik (mireqenia fiziologjike) qe mund te sigurojme brenda ambienteve te kopeshtit jane ne vartesi te destinacionin te perdorimit te ambienteve. Te dhenat e meposhteme jane perdorur si referenca per projektin.

Vendndodhja

Gjersia gjeografike

Per periudhen e ngrohjes - Dimer

SARANDE

42 ° 20'

Temperatura e brendshme llogaritese

20 – 23 °C

Lageshtia relative e brendshme

40 – 50 %

Levizja e ajrit ne mjediset e punes

0.13 - 0.15 m/sek

Qarkullimi i brendshem

1.0 – 1.5 nderime/ore

Grade dite te ngrohjes

995 grade-dite

Periudha e ngrohjes

01/11 – 26/03

Ditet e ngrohjes

222 dite

Temperatura mesatare e Janarit

2 °C

Lageshtia relative mesatare e Janarit

90 %

Temperatura e jashteme llogaritese

- 1 °C

Per periudhen e freskimit – Vere

Temperatura e brendshme llogaritese	23 – 25 °C
Lageshtia relative e brendshme	60 – 70 %
Levizja e ajrit ne mjediset e punes	0.16 - 0.23 m/sek
Qarkullimi i brendshem	1.0 – 1.5 nderime/ore
Temperatura maksimale e muajit te nxehte	40 °C
Temperatura mesatare e muajit te nxehte	25 °C
Lageshtia relative mesatare e muajit te nxehte	55 %

NR	VLERAT E REKOMANDUARA TE “ Tb” NE NDERTESAT SIPAS PERDORIMIT TE TYRE		
	Klasa	Destinacioni i perdorimit	Temperatuare e brendshme
1	E1	Ndertesat banimi	
	E. 1.1	Ndertesat banimi me karakter te vazhdueshem , civile dhe rurale , kolegje , kazerma etj.	
	E. 1.2	Ndertesat banimi me okupim me hope sikurse per vakanca , fundjave etj.	
	E.1.3	Ndertesat per hoteleri , pensione ose aktivetete te ngjashme	20 °C
		Dhoma ndenjeje	16 ÷ 18 °C
		Dhoma fjetje	20 °C
		Banjo	18 ÷ 20 °C
		Guzhine	12 °C
		Koridore , Wc	12 °C
		Hapsiara e shkalleve	12 °C
		Lavanderi	
	E2	publike ose private	20 °C
	E3	Ndertesat per spitale , klinika ose shtepi kurimi	
		Vizita mjekesore	22 ÷ 24 °C
		Dhoma fjetjeje per te semure	20 ÷ 22 °C
		Salla operacioni	24 ÷ 30 °C
	E4	Ndertesat per kinema , teatro , salla mbledheje per kongrese ,modele , museume , biblioteka vende kulti ,bare , restorante , salla vallezimi	
		Kinema , teatro , salle koncerti	20 °C
		Ambjente kulti , salla vallzimi dhe ekspozimi	14 ÷ 16 °C
		Muzeume , salla ekspozimi, arkiva dokumenetesh.	16 ÷ 18 °C
		Bare , restorante	20 °C
		Biblioteka	18 ÷ 20 °C
	E5	Ndertesat per aktivitet tregtar , dyqane, mgazina shitje , supermarketete	
		Hollet, koridoret, komplekse tregtare dhe supermarketete	16 ÷ 18 °C
		Magazina shitje	18 °C
		Dyqane te ndryshme	16 ÷ 18 °C
	E6	Ndertesat per aktivitet sportiv	
		Pishina , saune etj	≥ Temp. e ujit
		Palestra ,sherbime sportive dhe dushe	12 ÷ 14 °C
	E.7	Ndertesat per aktivitet shkollore tette gjitha niveleve	
		Klasa mesimi , dhoma mesuesi, auditore , banjo dhe dushe	20 °C
		Koridore dhe WC	15 °C
		Palestra dhe dushe	16 °C
		Shkallet	12 °C
	E.8	Ndertesat per aktivitetet industriale e artizanali.	14 ÷ 16 CC

Sistemi i ngrohjes/ ftohjes se godines eshte planifikuar te jete hidronik me ngrohje/ ftohje me fan-coil dysHEME te cilat tregohen ne vizatimet perkatese. Burimi i energjise do te sigurohet nga Chilleri per ujin e nxehte dhe per ujin e ftohte i cili do te jete version pompe nxehtesie. Uji i ngrohje/ ftohte do te shperndahet nga rrjeti i tubove qe do te furnizojne te gjitha terminalet ne ambientet e brendshme.

Niveli i zhurmave

Nivelet e zhurmave maksimale te lejuara brenda ambienteve jane percaktuar nga norma UNI 8199 dhe jane 35 dB(A) per dhomat e vilesit.

Kualiteti ajrit

Kualiteti i ajrit ka te beje me specifikat e ngushta te ambienteve, destinacionit dhe veprimtarise se tyre, ndotjes etj. Vete kuptohet qe per ta mbajtur ate ne kushte te pranueshme duhen siguruar parametrat e filtrimit dhe ventilimi me ajer te fresket duke siguruar ndrimet e rekomanduara te tij. Volumet e ajrit te venteluar jane percaktuar ne baze te normave dhe rekomandimeve, ne funksion te destinacionit te objektit dhe qe jane dhene ne kriteret projektuese.

Gjithashtu ambientet eshte mire qe te mbahen ne presion nepermjet nje diference sasive midis ajrit qe futet dhe atij qe del per rreth 0.5 volume /ore.

Nje aspekt tjetër i kualitetit te ajrit eshte shpejtesia e lejuar e fluksit te ajrit qe qarkullon ne ambient per shkak te ventilimit. Parametrat e shpejtesise se lejuar te qarkullimit te ajrit ne ambient parashikohen sipas standartit UNI 10339 dhe standartit ASHRAE 62/89R (modifikuar ne 1996).

Lageshtia relative

Vlera optimale e lageshtise relative eshte rreth 50% me shmangie $\pm 10\%$. Ne te vertete per arsye kursimi ne vleren e investimit dhe te perdorimit per ambiente E1(1) dhe E1(3) evitohet nje kontroll i sakte i saj, dhe per kete arsye lejohet qe te kemi shmangie ne kufijte 10% ne dimer. Permbajtja e lageshtires ne ambjent do te jete e kontrolluar. Kjo perfshihet brenda kufirit te konfortit termik sipas ASHRAE standard 55-1992 dhe UNI-EN-ISO 27730-96.

1.3 Humbjet e nxehtesise

Per te anlizuar ne menyre te kujdeseshme humbjet e nxehtesise jane konsideruar te gjithë faktorët qe influencojne per shkak te orintimit me horizontin, afersia me ambientet, karakteristikat termofizike te mureve rrethues, dritareve ,dyshemese, tavanit, paneleve sandwich etj.

Humbja e nxehtesise influencohet edhe nga popullimi i ambienteve, ndricimi, ventilimi natyral i ajrit etj, te cilat jane parapare ne termat e diskutuar paraprakisht me perfaqshues te investitorit.

Ngarkesat termike ne baze te natyres se faktorit dhe influences ne bilancin termik perlloriten si humbje ose si shtese termike, por gjithsesi ato qe influencojne ne menyre te drejteperdrejte jane:

- numri i personave prezent
- aktiviteti i tyre fizik
- niveli i ndricimit dhe aparatet elektrike te instaluar
- niveli i rrezatimit diellor
- infiltrimet e ajrit nga dyer-dritare (ventilimi natyral)

Te gjitha te dhenat e mesiperme kane sherbyer per klakulime nepermjet programit kompjuterik (software – it) te humbjeve ne stinen e dimrit dhe te veres si dhe specifikimet teknike te pajisjeve qe duhen perdorur.

Ngarkesat ne impiantin e kondicionimit kane nje specifike te cilat varet nga fakti qe jo te gjithë ambientet jane te ngarkuara ose te perdorura ne menyre konstante. Keshtu ky fakt kerkon ndertimin e grafikut te perqendrimit ose grafikun e veprimit te impiantit te kondicionimit i cili ka te beje me tipologjine e impiantit dhe shkallen e automatizimit, te kontrollit dhe komandimit te tij.

Te gjithë keto faktore siç kuptohet jo gjithnje paraqiten ne te njejten vlere dhe me te njejten influence prandaj konsiderohen si ngarkesa (humbje) termike variable.

Ndersa ne funksion te ndertesës nga pikepamja arkitektonike, materialeve ndertimore etj, rezultojne humbje termike konstante (humbjet nga muret, dritret, dyert, dyshemeja, soleta e tavanit, etj.)

Keto faktore kane influence konstante ne ngarkesat (humbjet) termike dhe si te tilla zgjidhen me mjaft kujdes ne menyre qe kostoja e ndertimit te impiantit mos kaloje qellimin e kursimit te humbjeve energjike, si dhe nga ana tjeter te mos mbidimensionohet impanti i kondicionimit.

Nga pikpamja e kapacitetit termik te pajisjeve nenvizojme se kapacitet per pikun e ngarkesës variojne ne menyre te konsiderueshme gjate dites bazuar ne variacionin e okupimit te ambienteve gje qe ka qene e parashikuar jo e rregullt .Per te shmanguar super dimensionimin e kapaciteteve te pajisjeve eshte analizuar paraprakishte profili i okupimit te zonave si dhe parashikimi paraprak i konsumit energjetik.

1.4 Perzgjedhja e sistemit

Karakteristikat e sistemit te perzgjedhur jane parashikuar ne vartesi te kriterëve te meposhtem:

- ✓ Fleksibilitet gjate gjithë kohës se shfrytezimit qe do te thote qe kapacitet e sistemit te sigurojne performance variabile gjate dites dhe ne sezone te ndryshme;
- ✓ Fleksibilitet ne kapacitet e terminaleve ne ambientet e destinuar;
- ✓ Te jete i afte te siguroje kondita ne perputhje me ato te parashikuara ne kriteret e projektimit per te siguruar nje mireqenie fiziologjike te kenaqshme;
- ✓ Kosto te ulet perdorimi dhe mirembajtje.

Meqellim qe te sigurohet nje limitim i konsumit energjetik, sistemi eshte parashikur te kete karakteristikat e meposhteme :

- ✓ Modulimi i operimit te sistemit ne funksion te ndryshimit te okupimit ne kohe dhe ne hapsire (temperaturae ujit te ngrohje/ ftohte ne dergim) ,si dhe te parametrave klimatike te ambientit te jashtem;
- ✓ Reagim automatik te terminaleve per te rregulluar ne menyre individuale temperaturën e ambienteve te brendshem ne intervale te limituar (valvolat tre degeshe).

2.6.1. Paisjet e kondicionimit

Sistemi i Ngrohjes dhe Ajrit te Kondicionuar do te jete ngrohës ne periudhen e ftohte dhe freskues ne periudhen e nxehte. Zgjidhja, sikurse u permend me siper,do te jete me ngrohje dhe ftohje me UJE. Te tera paisjet e jashtme qe eshte menduar te vendosen ne pjesen e mbrapme te objektit jane multikomprese dhe si rrjedhoje konsumimi elektrik i tyre do te jete i minimizuar .

Cdo ambient i vecuar nga te tjeret do te kete paisjen e saj te kondicionimit fancoil dysheme e cila do te beje riqarkullimin e ajrit nepermjet grilave te thithjes dhe atyre te dergimit si dhe do beje matjen e temperatures me ane te sondave te temperatures do kene termostat te dedikuar per cdo ambjent.

Kontrolli zonal

